

# PROGRAMI PËR DECENTRALIZIM DHE ZHVILLIM LOKAL NË RAJONIN E LEZHËS DHE TË SHKODRËS

Vlerësim Tematik

Antonin Braho  
Shkurt-Mars 2013

Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
And Cooperation SDC



Swiss Intercooperation

ALBANIA

**Ky publikim është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim**

**Përgatitur nga:  
Antonin Braho**

**Ky publikim reflekton mendimet e autorit dhe jo detyrimisht të SDC.**

**Publikuar nga:  
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)  
HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania  
Copyright © HSI Albania**

**Rr. Oso Kuka, Nr. 11,  
4000 Shkodër, Albania  
[www.dldp.al](http://www.dldp.al)**

---

Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
And Cooperation SDC



ALBANIA

## Përmbajtja

## Faqe

<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>1</b>
<b>1 KONTEKSTI I DLDP-SE</b> .....	<b>5</b>
1.1 Mjedisi Ekonomik.....	5
1.2 Mjedisi Politik .....	6
1.3 Decentralizimi, gjendja aktuale.....	6
1.4 Dldp, veshtrim i pergjithshem .....	8
1.5 Nje Veshtrim mbi Gjetjet dhe Rekomandimet e Rishikimit te Fundit te Programit .....	9
<b>2 OBJEKTI DHE METODOLOGJIA E VLERESIMIT TEMATIK</b> .....	<b>10</b>
2.1 Qëllimi i këtij ushtrimi.....	10
2.2 Një vështrim mbi fushat e vlerësuara te projektit dhe indikatorët .....	10
2.2.1 Vërejtje te përgjithshme lidhur me situatën aktuale në qeverisjen lokale dhe dldp-në .....	10
2.2.2 Përfundimet e Synuara dhe Rezultatet e Pritura te dldp-se ne fazën e II.....	11
2.2.3 Lista e indikatorëve, metodologjia e vlerësimit dhe domethënia e saj.....	12
<b>3 SHQYRTIMI I DETAJUAR DHE GJETJET KRYESORE</b> .....	<b>13</b>
3.1 Përfundimi i Synuar 1: Bashkitë dhe Komunat ne rajonin e Shkodrës dhe te Lezhës kane përmirësuar strukturat, kapacitetet qeverisëse, dhe shërbimet e zgjedhura publike.....	13
3.1.1 Buxhetet e mbështetura ne Politika .....	13
3.1.2 Parashikueshmeria e buxheteve.....	14
3.1.3 Planifikimi dhe buxhetimi transparent dhe me pjesëmarrje .....	14
3.1.4 PSZH te integruara vertikalisht .....	17
3.1.5 Kapacitete të njohurive dhe kapacitete institucionale të përmirësuara për NJQV .....	17
3.1.6 Prani e shtuar e PSZH, PBA ne NJQV .....	18
3.2 Shqyrtimi i Impaktit te Programit.....	19
3.3 Shqyrtimi ne teresi i indikatoreve – Permbledhje e Gjetjeve .....	20
3.4 Mësimet e Nxjerra ne Tërësi.....	21
<b>4 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>21</b>
4.1 Konkluzione .....	21
4.2 Rekomandime .....	21
<b>5 ANEKSE</b> .....	<b>23</b>

## **SHPJEGIME NE SHKURTIMET**

BE	Bashkimi Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikave
MF	Ministria e Financave
IPF	Instrumenti i Planifikimit Financiar
NJMP	Njësia e Manaxhimit të Programit
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat Njerëzore
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
PBA	Plani Afatmesëm Buxhetor
PCM	Cikli i Manaxhimit të Projekteve
PD	Partia Demokratike
PEFA	Vlerësim i Kuadrit të Shpenzimeve Publike
PO	Përgjegjës Projekti
PPB	Produkti i Përgjithshëm Bruto
PS	Partia Socialiste
PSZH	Planet Strategjike të Zhvillimit
QSH	Qeveria Shqiptare
SDC	Swiss Agency for Development and Cooperation
TAP	Tatimi mbi të Ardhurat Personale
TF	Tatim Fitim
TVSH	Taksa mbi Vlerën e Shtuar

## PËRMBLEDHJE

### Programi dhe Marrëveshja e Financimit

Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (*dldp*) filloi fazën e dytë të tij në mars 2010 dhe zgjati deri në shkurt 2013. Shtrirja gjeografike e programit mbulon 33 Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV) në Qarkun e Shkodrës dhe 21 në atë të Lezhës. Popullsia totale në rajon arrin në 554000 banorë, nga të cilët 40 % jetojnë në zona urbane dhe përafërsisht 30 % jetojnë në nivelin e varfërisë (sipas vlerësimeve zyrtare ne 2004).

Qëllimi kryesor i *dldp*-së është: *të rrisë kapacitetet e njësive të qeverisjes vendore në Shkodër dhe Lezhë në mënyrë që të kontribuohet në zhvillimin rajonal në Shqipërinë Veriore dhe në reformën e decentralizimit në nivel kombëtar.*

Agjencia donatore	Agjencia Zvicerane për Zhvillimin dhe Bashkëpunim(SDC) Divizioni i Ballkanit Perëndimor Freiburgstrasse 130 3003 Bernë Zvicër Tel. +41 31 322 44 05, Fax +41 31 323 59 33 SDC/SECO Zyra e Agjencisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim c/o Ambasada e Zvicrës Rruga Brigada e VIII P2/2/1 Tirana Shqipëri Tel. +355 4 240 102, Fax +355 4 240 103
Agjencia Zbatuese	Helvetas Swiss Intercooperation Fondacioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Maulbeerstrasse 10 P.O. Box 6724 3001 Berne Zvicër T +41 31 385 10 10 F +41 31 385 10 09 <a href="http://www.helvetas.org">www.helvetas.org</a>  Helvetas Swiss Intercooperation ne Shqiperi L. Kongresi Përmetit Rruga Oso Kuka Nr.11 Shkdora, Shqiperi T/F: +355 22 50 999 / 50 247
Numri i Programit SDC	Nr i Referencës 7F-04382.02
Partnerët Kryesorë	Njësit e pushtetit lokal (bashki dhe komuna) rajonin e Shkodrës dhe të Lezhës, Shqipëria Veriore, Shoqata e Bashkive dhe Komunave, Ministria e Brendshme.
Kohëzgjatja e Fazës Marrëveshja për kuadrin ligjor të kontratës	Mars 2010 – Shkurt 2013 Marrëveshja bilaterale midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Zvicrës, Marrëveshja e Projektit me Ministrinë e Brendshme të Shqipërisë.
Kontrata e Projektit	Mbajtës i kontratës është Helvetas Swiss Intercooperation i mandatuar nga SDC

### Konteksti

#### *Ekonomia:*

Indikatorët e përgjithshëm makroekonomikë dëshmojnë që ekonomia shqiptare është duke përparuar në procesin e ndryshimit dhe transformimit nga një ekonomi e një vendi në zhvillim, ku burimet kryesore të rritjes ekonomike janë aktivitetet ekonomike që kanë të bëjnë me nxjerrjen dhe eksportin e lëndëve të para dhe minerare, drejt një ekonomie më dinamike ku vlera e shtuar në ekonomi vjen kryesisht nga aktivitetet e prodhimit dhe shërbimit. Megjithatë, në kushtet e tregjeve të paqëndrueshme financiare globale si pasojë e niveleve të larta të borxhit publik në

eurozonë dhe situatës shqetësuese ekonomike në Greqi dhe Itali, rruga e mëtejshme e zhvillimit ekonomik në Shqipëri mund të ndikohet nga rreziqet e lidhura me zhvillimet ndërkombëtare dhe rajonale për arsye të ekspozimit të lartë që ka Bilanci i Pagesave të vendit ndaj këtyre ekonomike si pasojë e Bilancit Tregtar dhe Transfertave të emigrantëve dhe diasporës shqiptare që jeton në këto vende.

**Politika:**

Situata politike gjatë periudhës 2009-2012, e cila korrespondon me fazën I dhe II të zgjatjes së *dldp-së*, pavarësisht se e qëndrueshme, është acaruar disa herë për shkak të diskutimeve midis aktorëve kryesore politike. Procesi i aderimit në Bashkimin Evropian (BE) ka përparuar në mënyrë të ngadalshme; në dhjetor 2012, Këshilli i Evropës dhe Parlamenti Evropian vendosën që t'i japin Shqipërisë statusin kandidat sapo të arrihet një progres i nevojshëm në fusha të caktuara dhe më konkretisht në fushën e gjyqësorit, të administratës publike dhe të procedurave parlamentare. Zgjedhjet e reja të përgjithshme parlamentare janë programuar të mbahen në qershor 2013.

**Decentralizimi:**

Pavarësisht se reforma e decentralizimit është angazhim, shpejtësia e zbatimit të saj mbetet ende e ngadaltë. Ligji i financave lokale i projektuar që në vitin 2008 nuk është miratuar dhe zbatuar ende dhe sot e kësaj dite. Decentralizimi fiskal është ende në fazën fillestare dhe burimi i vetëm domethënës i të ardhurave, i kaluar nga qeveria qendrore qeverisë lokale është Taksa e Biznesit të Vogël (TBV); të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë janë ende modeste për të siguruar burime të mjaftueshme për NJQV-në. Ka një konsensus në rritje për t'i transferuar më tepër burime të ardhurash pushtetit lokal nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në taksat kombëtare (si direkte dhe jodirekte); megjithatë, ende nuk ka vendime përfundimtare në këtë drejtim. Për më tepër, tipologjia e qeverisjes lokale në Shqipëri karakterizohet nga ekzistenca e shumë NJQV-ve të vogla, aftësia e të cilave për të ofruar shërbime publike në mënyrë efektive dhe efçente mbetet e kufizuar- në vetvete kjo tregon nevojën për reforme në këtë drejtim. Ndërsa huamarrja mbetet një pamundësi praktike për shkak të masës së madhe që zë borxhi i qeverisë qendrore në borxhin publik, burimet kryesore të të ardhurave për NJQV-të mbeten transfertat buxhetore qeveritare, madhësia e të cilave gjatë periudhës së punës së *dldp-së* ka patur luhajtje.

**Vlerësimi i Përgjithshëm i Programit dhe disa gjetje**

Ky raport është rezultati i një vlerësimi tematik të arritjeve të *dldp-së* në lidhje me aktivitetet e programuara në mbështetje të Planifikimit Strategjik dhe Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PSZH/PBA) bazuar në monitorimin e disa indikatorëve. Metodologjia e vlerësimit kombinon rishikimin e dokumenteve dhe studimeve të prodhuara gjatë programit dhe intervista dhe anketa mbi pyetësorë me përfituesit e projektit.

Nga vlerësimi i bërë, mund të arrihet në përfundimin që projekti ka patur një ndikim të mirë në shumicën e indikatorëve. Pavarësisht vështirësisë për të vlerësuar progresin për shkak të padisponueshmërisë së informacionit analog krahasues në bazë (periudhën e nisjes së projektit) për disa nga indikatorët, duket qartë që NJQV janë duke lëvizur ngadalë drejt buxheteve të orientuara nga politika dhe programeve nëpërmjet proceseve të PBA-së dhe Instrumentit të Planifikimit Financiar (IPF) të prodhuara si rezultat i programit. Puna e bërë ka patur ndikim të mirë po ashtu dhe në procesin e transparencës së përgatitjes së buxheteve vendore të paktën përsa i përket sasisë së informacionit.

Ka po ashtu një impakt të gjerë të programit veçanërisht në sasinë dhe cilësinë e PSZH-ve të prodhuara dhe koordinimin e tyre me PBA sidomos në NJQV të instruktura në fazën e dytë të *dldp-së*.

Dimensioni i ngritjes së kapaciteteve është gjithashtu një zonë ku programi duket se ka patur një ndikim të mirë dhe në linjë me indikatorët e zgjedhur në kuadrin logjik të projektit. Objektivi për kriteret e gjinisë janë arritur gjatë gjithë ecurisë së programit, gjë që tregon vetëdijen e programit për rëndësinë e këtij kriteri dhe domethënien e tij në kontekstin shqiptar.

Me poshtë po paraqesim më në detaje disa nga gjetjet e këtij vlerësimi:

**Gjetjet Kryesore:** Aktualisht, në kontekstin e uljes së ritmeve të rritjes ekonomike, mjedisi i përgjithshëm në Shqipëri për zhvillimin e trajtimeve strategjike në fushën e menaxhimit të financave publike në nivel lokal është sfidues. Si i tillë ai ka të beje me

burime financiare të kufizuara, dmth shtrengesa buxhetore qe detyrojne pushtetin lokal te perqendrohet ne perballimin e realitetit te zgjidhjeve te perditshme me teper se ne aspektet e vendimeve te lidhura me proceset strategjike dhe ato te manaxhimit te financave publike ne nivel lokal.

Pavarësisht koheve te veshtire, njesite e qeverisjes vendore, dldp-ja, jane duke levizur drejt proceseve standarde te planifikimit strategjik ne fushen e manaxhimit te financave publike, rezultatet e te cilave duket te çojne ne vendime me cilesore nga pikëpamja e arritshmerise se programeve dhe aktiviteteve.

Shmangiet midis PBA dhe buxheteve vjetore vazhdojne ende te mbeten te medha dhe pavarësisht përmirësimeve rrezikohen nga burime te pasigurta si pasoje e parashikueshmerise se ulet te transfertave nga qeveria qendrore.

Perdorimi i mjeteve standarde te planifikimit buxhetor afatmesem ka rritur cilesine e perpilimit te PBA, per rrjedhoje produkti IPF ka sjelle perfitime te medha per perfundimet e synuara te programit. Gjithesesi, ka nevojte qe mjete te tilla te përmirësohen akoma me tej nepermjet futjes se standardeve kombetare sidomos ne kodifikimin dhe klasifikimin programatik te shpenzimeve ne menyre qe te përmirësohen akoma me tej mundesite e shtrirjes ne zona te tjera dhe te gjenerohet mbështetje per produktet e *dldp*.

Pavarësisht progresit modest ne parashikueshmerine e buxheteve, mbetet ende per te bërë ne menyre qe te rritet thellesia dhe qendrueshmeria e PBA si mjete monitorimi per planifikimin buxhetor. Perderisa ka zhvillime te reja ne lidhje me borxhin publik, eshte e nevojshme qe programi te marre ne konsiderate mundesine e integritit te vleresimit te borxhit ne IPF dhe ne PBA qe shkojne pertej shpalljes se thjeshte te shumes se huave apo kredive.

Pavarësisht informacionit pak a shume te disponueshem per publikun ne procesin e pergatitjes se buxhetit, cilesia e tij ka nevojte te përmirësohet. Ritmet e rritjes ekonomike jane ende shume te thjeshta dhe te paargumentuara ne PBA dhe ne PSZH.

Perfshirja e autoriteteve rajonale si grupe te interesit dhe pale ne procesin e pergatitjes se PBA dhe PSZH duket problematike. Po ashtu, prioritetet/mundesite rajonale dhe kombetare jane ende larg integritit ne PSZH nepermjet nje kuadri sistematik te vleresimit te ketyre mundesive.

Cilesia dhe sasia e PSZH-ve jane permiresuar me kalimin e kohes. Programi *dldp* duket se ka luajtur nje rol te rëndesishem ketu nepermjet komponentit te tij te aktiviteteve te perqendruara ne ndertimin e kapaciteteve dhe procesit te konsultimit ndermjet eksperteve te NJQV-ve. Megjithate, PSZH-të ne përgjithësi kane mungesa te shprehjes se aktiviteteve ne kosto sipas nje standardi te perbashket të harmonizuar me PBA-në, mekanizmat monitorues, entitetet pergjegjese per zbatimin e aktiviteteve, shprehjen ne terma sasiore te rreziqeve dhe veprimet qe duhen te ndiqen ne rast se keto rreziqe materializohen. Metodologjite e shqyrtimit dhe te vlerësimit te mjedisit (SWOT ose te ngjashme me te) jane prezente vetem ne disa nga PSZH-të e hartuara.

Aktivitetet e ndertimit te kapaciteteve jane zbatuar sipas programit dhe ne pergjithesi kane rezultuar mire sipas kuadrit logjik te monitorimit. Kriteri i gjinise eshte respektuar, gje qe tregon vetedijen e programit per domethenien e ketij kriteri ne mjedisin shqiptar.

Pavarësisht permiresimeve ne forme dhe ne cilesine e PSZH-ve, ende nuk ka nje reflektim ose vendimarrje ne lidhje me integritin e kohezgjatjes se ketyre strategjive dhe procesit te rishikimit.

Zgjedhja e strategjise për udhëzim ka qene shume efektive ne përmirësimin e cilesise se PBA-ve dhe PSZH-ve te hartuara.

IPF është një mjet i dobishëm, i cili nepermjet hapave teper analitike ne procesin e pergatitjes se buxhetit afatmesem, ka mundesine te shtoje qartesi dhe realizem gjate procesit te pergatitjes se PSZH-së.

### **Rekomandime**

Ne lidhje me metodologjine e kombinimit te PSZH-së me PBA-në ne nje te vetme ne procesin e zbatimit te ketij programi, rekomandohet qe programi te vazhdoje ne te njejten rruge. Proceset, mjetet dhe standardet tashme te arritura do ta bejne koston e aktiviteteve te ardhshme me te ulet dhe perfitimi do te jete me i madh. Megjithate, çdo program i ri duhet t'i kushtoje vemendje pershtatjes me standardet kombetare ne menyre qe te promovohet dhe te sigurohet qendrushmeria e rezultateve te arritura ne te ardhmen.

Programi ka nevojte qe te kapitalizojte ne iniciativat, standardet, udhezimet rajonale dhe kombetare ne menyre qe te rrise ndikimin e tij veçanerisht ne fushat qe kane nje lidhje direkte me manaxhimin e financave publike (disponueshmeria e informacionit te buxhetit, kanalet e komunikimit, kalendari i aprovimit te buxhetit, struktura e raporteve dhe formateve te buxhetit etc.)

Ka nevojte per me teper pune ne menyre qe PBA-të te jene mekanizma qe jo vetem t'i sherbejne procesit te hartimit te PSZH-ve por edhe te monitorimit te tyre. Eshte e nevojshme qe PBA-të te jene programe me indikator, rreziqe perkatese, pergjegjesi dhe veprime qe duhet te kryhen nese objektivi i synuar nuk arrihet.

Eshte e nevojshme pershtatja me iniciativat ne nivel kombetar per te rritur menyre dhe shtrirjen e te ardhurave lokale me te tjera taksa ose per te krijuar "zona relativisht te sigurta" per te ardhurat lokale ne menyre qe te garantohet siguria e parashikimeve fiskale te te ardhurave/shpenzimeve lokale dhe rrjedhimisht te sigurohen sherbimet publike.

PSZH-te duhet te integrojne nje shqyrtim te detajuar te mundesive rajonale dhe kombetare dhe te permbajne plane veprimesh sa me afer realitetit nepermjet PBA-ve.

Instrumenti i Planifikimit Financiar duhet te shtrihet ne pjesen e mbetur te komunave me permirësime shtese te pershtatura me zhvillimet kombetare; si nje shembull ilustrimi, programi mund te mendoje per mundesine e zgjerimit ose te shtimit te nje moduli dedikuar borxhit.

Eshte e nevojshme qe *dldp-ja* te kapitalizojte dhe promovojte disa nga materialet e hartura ne vite si shembuj te praktikave te mira dhe te mbeshtese çdo iniciative kombetare per ushtrime standarde ne fushen e manaxhimit te financave publike (si p.sh. PEFA lokale- shkurt Shqyrtimi i Kuadrit te Shpenzimeve Publike ne nivel lokal), te cilat mund te rrisin vetedijen rajonale dhe kombetare per programin dhe mbeshtetjen per perfundimet e synuara te tij.

Praktika e konsultimeve ndermjet eksperteve te NJQV-ve duhet te jete pjese e procesit dhe kurdohere qe te jete e mundur, duhet te perfshije perfaqesues nga niveli rajonal dhe kombetar i qeverise, ne menyre qe te lehtesoje perfshirjen e tyre ne procesin e PBA-së dhe PSZH-së dhe te rrise ndikimin pertej zones se programit.

### **Konkluzione**

Ky raport arrin ne konkluzionin qe *dldp-ja* ka qene nje program efektiv dhe pergjithesisht i suksesshem se paku ne fushat e lidhura me perfundimin e synuar 1. Projekt-ideja, kalendari dhe aktivitetet duket qe i kane sherbyer mire nevojave te perfituesve dhe siç shihet nga vleresimi i pergjithshem kane patur nje ndikim te mire ne indikator per NJQV-te, objekt i ketij vleresimi.

Perderisa ky program perfundon dhe eshte e nevojshme te merret nje vendim per fazen e ardhshme, ky raport sugjeron si drejtime te aktivitetit ne te ardhmen:

- Thellimin e proceseve cilesore te sistemit te manaxhimit te financave publike ne fusha te tjera te tij p.sh: prokurimet publike, auditimi i brendshem dhe i jashtem etj. siç percaktohen nga ushtrimet standarde ne kete disipline (PEFA)
- Shtrirjen dhe shumefishimin e aktiviteteve te programit ne NJQV te mbetura ne Shkoder apo Lezhe apo dhe diku tjeter ne Shqiperi.



## 1 KONTEKSTI I DLDP-SË

Seksionet e mëposhtme japin një skicë të shkurtër të situatës ekonomike, politike dhe të decentralizimit aktualisht dhe në të ardhmen e afert, duke theksuar ato aspekte që janë menduar si më domethënëset për detyrën e këtij ushtrimi, me saktësi: vlerësimin tematik të fazës 2 të dldp në qarkun e Shkodrës dhe Lezhës.

### 1.1 Mjedisi Ekonomik

Në vitin 1991, Shqipëria ishte një nga ekonomitë më pak të zhvilluara post-komuniste në Evropë. Produkti i Përgjithshëm Bruto (PPB) ra me mbi 30% në dy vitet e para të tranzicionit në ekonominë e tregut (1991-1992); rritja ekonomike rifilloi fuqishëm me vonë dhe vazhdoi me ritme të larta deri në 2009. Për rrjedhojë varferia ul dhe në vitin 2010, Produkti i Përgjithshëm Neto për kapital ishte në nivelin e 3,960\$.

Në kontrast me shumë vende të tjera Evropiane, Shqipëria i kaloi valet e para të krizës financiare globale të 2009 mirë dhe arriti të shmangte një kontraktim të prodhimit. Edhe pse në dukje me rezistente ndaj shokut ekonomik të ekonomitë e tjera në rajon, ekonomia e Shqipërisë gjithsesi u ndikua nga kriza ekonomike botërore duke patur si pasoje uljen e shpejtesisë së rritjes ekonomike pas vitit 2009. Sektorët kryesorë të goditur nga renia e rritjes ekonomike ishin ndertimi dhe industria nxjerrëse, të cilat së bashku vuajnë pasojat e uljes së kërkesës së brendshme dhe të jashtme.

Të dhënat e fundit nga Banka Qendrore e Shqipërisë, Ministria e Financave (MF) dhe Fondi Monetar Nderkombëtar (Aneksi 3) tregojnë që ekonomia shqiptare është duke avancuar në procesin e transformimit nga një ekonomi e një vendi në zhvillim, ku burimet kryesorë të rritjes janë aktivitetet ekonomike të shoqëruara me nxjerrjen dhe eksportin e lendeve të para dhe materiale, në një ekonomi me dinamike ku vlera e shtuar vjen kryesisht nga aktivitetet e prodhimit dhe shërbimit. Megjithatë, në kushtet e tregjeve të paqëndrueshme financiare globale si pasoje e niveleve të larta të borxhit publik në eurozonë dhe situatës shqetësuese ekonomike në Greqi dhe Itali, rruga e metejshme e zhvillimit ekonomik në Shqipëri mund të ndikohet nga rreziqet e lidhura me zhvillimet nderkombëtare dhe rajonale për arsye të ekspozimit të lartë që ka Bilanci i Pagesave të vendit ndaj këtyre ekonomive si pasoje e Bilancit Tregtar dhe Transfertave të emigrantëve dhe diasporës shqiptare që jetojnë në këto vende.

Në të kaluarën Qeveria Shqiptare (QSH) ka reaguar me kujdes ndaj rreziqeve dhe goditjeve të jashtme ekonomike. Përsa i përket financave qeveritare, të dhënat tregojnë se pavarësisht rritjes së defiçitit fiskal para vitit 2009 për shkak të shpenzimeve të mëdha kapitale (kryesisht në rrugë dhe të tjera vepra të infrastrukturës publike), QSH-ja ka reaguar shpejt me shkurtime shpenzimesh për të sjellë balancën e përgjithshme fiskale në nivele rreziku me të ulëta. Shkurtime kryesore kanë qenë në shpenzimet kapitale, gjë që tregon një vetepërbajtje të QSH-së për të prekur shpenzimet e lidhura me programet dhe politikën që kanë pasojat sociale. Defiçiti ka qenë i financuar kryesisht nga burime të brendshme, kështu që borxhi i Shqipërisë nuk ka qenë dhe aq shumë i ekspozuar ndaj rreziqeve të levizjeve lart/poshtë të tregjeve financiare botërore. Megjithatë, rrugedalja ndaj burimeve të brendshme të huamarrjes ka patur një ndikim direkt në uljen e kreditit të disponueshëm për individët dhe sektorin privat në funksion të financimit të mundësive të rritjes ekonomike, gjë që reflektohet dhe në nivele më të ulëta të kontributit të sektorit të ndertimit dhe pasurive të patundshme në rritjen e ekonomisë pas vitit 2009. Kjo tendencë pritet të vazhdojë dhe në të ardhmen e afert, përderisa Parlamenti së fundi (dhjetor 2012) vendosi të modifikojë Ligjin Organik të Buxhetit, i cili përshkruante një nivel 60% të PBB si limiti absolut i borxhit publik. Kjo levizje u justifikua me nevojën e vendit për të krijuar me tepër hapësirë për levizje kundërbalancuese në anën e kërkesës për të përballuar presionin në rritje mbi financat publike të ritmeve të rritjes së PPB në ulje.

Duke vazhduar në fushën e financave qeveritare, të ardhurat tatimore në Shqipëri janë pak më tepër se 23% e PPB-së, e cila tregon një nivel pak a shumë të mirë kur dihet që vendi aplikon sistemin e taksës së sheshtë në nivelin 10% si për tatimin mbi fitimin (TF) ashtu dhe për tatimin mbi të ardhurat personale (TAP). Gjithsesi, burimi kryesor i të ardhurave tatimore mbetet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), që tregon se Shqipëria ka ende shumë për të ecur në rrugën e krijimit të një sistemi të plotë dhe të ekuilibruar nga pikepamja e barres fiskale mbi kapitalin dhe konsumin. Shpenzimet, pavarësisht pikut në vitin 2009, për shkak të programeve të mëdha të investimeve publike, janë shkurtuar në vitet në vazhdim për të mbajtur nën kontroll defiçitin fiskal në nivelin e 3.5%-4% of PPB si shenjë e maturisë ekonomike; shpenzimet për pushtetin lokal kanë qenë pak a shumë të qëndrueshme në vitet 2008-2012 brenda rangut të 2-2.5% of PPB.

Per vitet ne vazhdim, parashikimet e meparshme makroekonomike te QSH-se ishin te rendit 5-6% ritem rritje te PPB real, qe ishin me teper se optimiste duke patur parasysh zhvillimet e fundit negative ne vendet partnere kryesore tregtare te Shqiperise: Itali dhe Greqi. Megjithate, nje skenar i ri u gjenerua ne fillim te vitit 2013, i cili merr me mire parasysh keto zhvillime dhe ul parashikimet e meparshme. Gjithmone duke iu referuar ketij skenari, ritmet e rritjes reale te PPB per vitin 2012-2013 do te jene 1.5-3.5% qe gjithsesi mbeten me te larta se ritmet e rritjes te gjeneruara nga FMN, Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Boterore (BB) te cilat bien ne intervalin 0.5-1.3% per te njejten periudhe.

## **1.2 Mjedisi Politik**

Situata politike ne Shqiperi mund te pershkruhet me mire duke analizuar progresin e Shqiperise ne aderimin ne BE, si lokomotiva kryesore e reformave demokratike, te qeverisjes dhe ekonomike ne vend..

Aplikimi i Shqiperise per anetaresim ne BE me 28 prill 2009, u konsideruar si nje etape e rendesishme ne tranzicionin e Shqiperise nga nje vend komunist ne nje vend me demokraci te konsoliduar dhe ekonomi tregu.

Situata politike gjate 2009-2012, e cila korrespondon me jetegjatesine e dldp-se, eshte tensionuar te pakten dy here per shkak te debatit politik ndermjet partive kryesore, Partise Demokratike (PD) ne qeveri dhe Partise Socialiste (PS) ne opozite, si pasoje e zgjedhjeve parlamentare te vitit 2009 dhe zgjedhjeve lokale 2011. Te dy proceset zgjedhore u vezhguan nga OSBE dhe ODIHR, te cilat theksuan qe megjithese zgjedhjet treguan progres te prekshem dhe permiresime te ndryshme, prape keto permiresime u zbehen nga politizimi i aspekteve teknike te procesit.

Kontestimi i rezultateve zgjedhore ka çuar ne ngerç politik te shenjuar nga bojkoti parlamentar i opozites, i cili mbaroi ne shtator 2011, kur PS vendosi te hyje ne Parlament ne menyre qe t'i jape nje shtyese perpjekjeve te Shqiperise per te permbushur kriteret e pranimit ne BE. Nje marreveshje politike midis partise qeveritare dhe atyre ne opozite mbi planin dhe kalendarin e reformes elektorale, permiresimin e rregullave dhe procedures parlamentare dhe aprovimin e ligjeve qe kerkonin shumice te cilësuar, u hartua menjehere pas nentorit 2011.

Rezultatet gene mbreselenese:

- Shume nga ligjet qe kerkonin nje shumice te cilesuar u aprovuan.
- U emerua Avokati i Popullit me nje proces dhe kandidat te zgjedhur nga opozita dhe duke qene dakord me partine qeverisese.
- Seanca degjimore dhe votimi parlamentare u mbajten me sukses per emerimin nje gjykatesi ne Gjykatën e Larte.

Me 11 qershor 2012, u zgjodh presidenti i ri ne perputhje me amendamentet kushtetuese megjithese pa konsensusin e opozites. Perseri ky fakt kontribuoi ne nje tension te ri te panevojshem politik dhe demtoi perpjekiet per reforma ne fusha kyçe te cilat kerkojne konsensus politik dhe qe motivuan Komisionin Evropian qe Shqiperise t'i jepet statusi i kushtezuar i vendit kandidat per ne BE.

Me 12 dhjetor 2012, Keshilli dhe Parlamenti Evropian, megjithese pershendeten progresin ne teresi te shenuar nga Shqiperia, sipas raporteve monitoruese te Komisionit Evropian, vendosen qe t'i akordojne Shqiperise statusin e vendit kandidat vetem kur progresi i nevojshem te arrihet ne disa fusha si ajo e gjyqesorit, reformes se administrates publike dhe rishikimit te rregullave dhe procedurave parlamentare, te cilat mund te arrihen vetem mbi bazen e konsensusit politik midis pales qeverisese dhe opozites. Ne vazhdimesi u theksua po ashtu qe "Mbajtja e zgjedhjeve te suksesshme parlamentare ne vitin 2013 do te jete nje test kryesor per funksionimin e mire te institucioneve demokratike ne vend".

Muajt e pare te vitin 2013, jane shoqeruar me debate dhe diskutime te ashpra politike, te cilat jane gjithmone te pranishme ne mjedisin politik shqiptar sidomos ne vitet elektorale siç eshte dhe rasti i ketij viti me zgjedhjet parlamentare qe jane programuar per tu mbajtur me 23 qershor 2013.

## **1.3 Decentralizimi, gjendja aktuale**

Duke dale nga pothuajse 50 vjet praktike e qeverisjes totalisht te perqendruar, Shqiperia hyri ne rrugen e decentralizimit ne fund te viteve '90. Vendi ratifikoi Kartën Evropiane te Vetëqeverisjes Lokale, perfshiu

parimet e saj baze ne Kushtetuten e re dhe kaloi reformat ligjore per veteqeverisjen lokale pas vitit 1998. Nje Strategji Kombetare per Decentralizimin dhe Ligje Organike per Qeverisjen Lokale u aprovuan per here te pare ne vitin 2000 dhe kane qene rishikuar te paktën dy here qe atehere. Keto ligje organike mbi " Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal" (Ligji 8652) dhe mbi " Ndarjen Administrative dhe Territoriale" (Ligji 8653) i dhane fund praktikës se Keshillave te vjeter te Rretheve dhe ndertuan per here te pare nje kuader ligjor qe lejonte struktura te decentralizuara fiskale dhe administrative funksionale, te cilat ne parim perfshijne qarqet, bashkite dhe komunat.

Pa dyshim qe procesi i decentralizimit nuk mund te jete efektiv pa qene i shoqeruar nga procesi i decentralizimit fiskal: nivelet e qeverisjes lokale (qarqet, bashkite dhe komunat) kane nevoje te kene burime te parashikueshme te dhenash nen fuqine e tyre ne menyre qe te ushtrojne ne menyre te pavarur funksionet e tyre dhe te ofrojne ne menyre efektive/efiçente sherbime publike per komunitetet e tyre. Pavarësisht nje kuadri ligjor pak a shume funksional qe rregullon punen e NJQV-ve, duket sikur ka disa hendeqe sidomos te lidhur me ndarjen e qarte dhe efektive te roleve/pergjegejsive ne lidhje me disa nga aktivitetet e qeverisjes lokale (per shembull pergatitjen, zbatimin dhe kontrollin e PBA-se dhe buxheteve vjetore ne nivel lokal dhe rajonal, shkallen e transparences etj). Ligji mbi Financat Lokale, i cili mund te kishte siguruar nje kuader ligjor solid per keto role/pergjegjisi, pavaresisht faktit qe eshte hartuar qe ne vitin 2008, nuk eshte ende ne zbatim.

Ne drejtim te shperndarjes territoriale/popullates, Shqiperia akoma ka nje sistem te qeverisjes lokale me shume NJQV te vogla. Aktualisht jane 373 NJQV nga te cilat pothuajse 41% kane nje popullate me te vogel se 5000 banore. Kjo shperndarje e ben efiçensen e sherbimeve publike ne nivelin lokal shume te veshtire per t'u arritur; prandaj eshte e kuptueshme perse ka nje ngurrim ne nivel qendror per te deleguar me teper pushtet dhe autonomi ne nivel lokal per sigurimin e sherbimeve publike. Megjithate, nevoja e avancimit ne kete drejtim eshte pranuar nga autoritetet qendrore dhe aktoret politike dhe se fundi ka nje konsensus ne rritje ne shkalle vendi qe Shqiperia ka nevoje te reformoje strukturat e administrimit territorial ne menyre qe te avancoje me teper procesin e decentralizimit fiskal dhe permiresoje praktiken e sherbimeve publike ne nivel lokal. Te dhenat e fundit e censurit te publikuara nga INSTAT-i ne fund te vitit 2012, priten te sigurojne nje baze te mire per kete reforme te shperndarjes territoriale dhe rrjedhimisht per caktimin e shpenzimeve dhe te ardhurave ne menyre qe te ushtrohen funksionet ekskluzive, te perbashketa dhe te deleguara te NJQV-ve.

Aktualisht kuadri ligjor lejon te gjitha NJQV-te te ushtrojne funksione ekskluzive, te perbashketa me pushtetin qendror dhe te deleguara mbi bazen e percaktimit te shpenzimeve pa konsideruar mjaftueshem kapacitetet e tyre financiare, teknike dhe njerezore per te siguruar sherbime publike ne menyre efiçente. Kur vjen çeshtja sidomos tek funksionet e perbashketa si shkollimi parauniversitar, sherbimi primar shëndetësor, furnizimi me uje dhe kanalizimet, mbrojtja e mjedisit dhe mbrojtja sociale, pamundesia e zyrtareve lokale per te ofruar sherbime efektive, duket se u ka dhene udhe deshtimeve qe jane amplifikuar ne shkalle kombetare nepermjet debateve te panevojshme politike ndermjet aktoreve politike.<sup>1</sup> Megjithese funksionet e ndara jane te justifikueshme nga pikëpamja ekonomike dhe sociale, ne Shqiperi, ka nevoje qe politika dhe praktika e percaktimit te shpenzimeve te bazohet gjithashtu dhe ne te qenurit gati dhe vullnetin e qeverisjes lokale ne te gjitha nivelet (komuna, bashki dhe qarqe) ne menyre qe te sigurohet permirësimi i sigurimit te sherbimeve publike per komunitetet lokale ne terma afatshkurter dhe afatgjate. Per aq kohe sa ne Shqiperi ka efektivisht dy shoqata te NJQV-ve me perkatesi te dalluara politike (nje ndaj qeverisjes aktuale dhe tjetra ndaj opozites), arritja e nje marreveshjeje qe funksionon ne kete drejtim mbetet ende nje sfide.

Nje pamje e tille e ngjashme eshte e pranishme gjithashtu dhe ne anen e percaktimit te te ardhurave. Ne Shqiperi, NJQV-te kane ende pak burime te ardhurash nen fuqine e tyre. TBV<sup>2</sup> e cila u mendua si nje nga shtysat e rritjes se nivelit te te ardhurave lokale nuk qe efektive:

- sepse niveli maksimal i saj deri me tani ka qene i ndikuar nga niveli i takses se sheshte prej 10% te aplikuar nga QSH-ja
- sepse baza e kesaj takse ka ardhur duke u ngushtuar si pasoje e disa vendimeve te MF-se per te ulur nivelin e qarkullimit te pergjithshem mbi te cilin aplikohet TVSH-ja.

Nje tjetër burim i mundshem i te ardhurave, taksa mbi pronesine, pavarësisht potencialit per te siguruar te ardhura te rendesishme per NJQV-ne me numrin me te madh te banoreve ka ende nje baze te vogel per shkak se progresi ne legalizimin e ndertimeve informale dhe zgjidhja e diskutimeve midis ish-pronarve dhe te ardhurve te rinj eshte i ngadalshem si pasoje e tensioneve politike dhe sociale.

<sup>1</sup> Nje shembull i mire ne kete pike ka te beje me sherbimin e ujesjellesave dhe kanalizimeve ne nivel lokal per shkak te borxheve te keqija te akumuluar ndaj Kompanise se Shperndarjes Elektrike CEZ ne gjysmen e dyte te vitit 2012.

<sup>2</sup> Subjektet qe paguajne TBV nuk jane subjekte qe i nenshtrohen TVSH.

Duke patur parasysh te gjitha sa u thane me siper, nuk duhet te tingelloje si surprize fakti perse burimet me te rendesishme te te ardhurave per NJQV-te mbeten transfertat qeveritare ne formen e transfertave te kushtezuara dhe te pakushtezuara. Ketu, pavarësisht nje niveli stabel te shpenzimeve te paracaktuara per pushtetin lokal prej 2-2.5% te PPB, transfertat per te dyja kategorite ne periudhen 2009-2011 kane ardhur duke u ulur ne buxhetet nacionale per shkak te performances se ulur ne te dyja aspektet, PPB dhe mbledhje e te ardhurave. Praktika e shperndarjes te transfertave te pakushtezuara nepermjet Fondit te Zhvillimit Rajonal nepermjet granteve konkruese u mendua qe te rriste eficënsen, pershtatjen me planet strategjike dhe konkrueshmerine midis NJQV sidomos ne fushen e investimeve dhe shpenzimeve kapitale. Megjithate, ne kete aspekt disa nga nga problemet qe duket se kane NJQV-te jane nje shporte me e vogel per te shperndare çdo vit, rregulla te diskutueshme ne zgjedhjen e projekteve dhe pershtatje ndaj planeve kombetare si prioritete ndaj atyre rajonale. Aktualisht niveli i granteve te pakushtezuara te transferuara ndaj NJQV-ve, percaktohet mbi bazen e nje formule te barazimit, e cila eshte e veshtire per tu kuptuar nga pikëpamja intuitive, kjo i ka dhene rruge sugjerimeve per mekanizma me te thjeshte te pjesemarrjes/ndarjes se te ardhurave per taksat kryesore si TF, TAP apo TVSH, gjithmone duke futur mekanizma kontrolli per te garantuar drejtesine dhe eficënsen e rezultateve.

Persa i perket burimit te te ardhurave nepermjet borxhit, megjithese i bazuar ne ligjin “Ligji per Huamarrjen e Pushtetit Lokal” (2008), aftesia e NJQV-ve ne praktike per te vepruar ne kete drejtim ne 3 vitet e fundit ka qene e kufizuar nga “Ligji Organik i Buxhetit” (2008) i cili postulonte nje nivel maksimum borxhi prej 60% dhe nivelet aktuale te borxhit publik te qeverise qendrore qe kane qene pothuajse afer nivelit limit.

#### 1.4 Dldp, vështrim i përgjithshëm

Programi për decentralizim dhe zhvillim lokal (Dldp) eshte pjese e strategjise te Kooperacionit Zviceran SDC/SECO per te mbeshtetur Shqiperine ne perpjekjet e saj per te avancuar procesin e demokratizimit dhe forcimit te ligjit. Ne veçanti, programi synon te mbeshtese procesin e decentralizimit ne Shqiperi ne menyre qe te konsolidoje demokracine dhe te siguroje standardet evropiane te sherbimit publik per qytaret si nje element thelbesor i Strategjise Kombetare per Zhvillim dhe Integrim. Shtrirja gjeografike e programit mbulon 33 Njese te Qeverisjes Vendore (NJQV) ne Qarkun e Shkodres dhe 21 ne ate te Lezhes. Popullsia totale ne rajon arrin ne 554000 banore, nga te cilet 40 % jetojne ne zona urbane dhe perafersisht 30 % jetojne nen nivelin e varferise (sipas vleresimeve zyrtare ne 2004).

Ne menyre te permbledhur faza aktuale 2 e dldp-se, e cila qe programuar per tu zbatuar ne hapesiren kohore midis periudhes mars 2010 -mars 2013, mund te pershkruhet si me poshte :

Qëllimi i Programit: Kapacitetet e bashkive dhe komunave ne Shkodër dhe Lezhë janë forcuar duke kontribuar në zhvillimin rajonal në Shqipërinë Veriore dhe reformën e decentralizimit në nivel kombëtar		
<b>Përfundimi i Synuar</b>	<b>1:</b> Bashkitë dhe Komunat në qarkun Shkodër dhe Lezhë kanë përmirësuar strukturat qeverisëse, kapacitetet dhe shërbimet publike të caktuara.	<b>2:</b> Praktika të mira janë bërë të ditura në nivel kombëtar në bashkepunim me shoqatat duke ndikuar keshtu ne ligj, vendimmarrje dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar.
<b>Produkte</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>1.1 Kapacitetet e NJQV në planifikim strategjik dhe buxhetim janë përmirësuar dhe NJQV e zgjedhura aplikojne instrumente dhe metoda të planifikimit strategjik të lidhura me buxhete vjetore dhe afatmesme.</li> <li>1.2 Kapacitetet e NJQV-së në manaxhimin financiar dhe fiskal , duke përfshirë proceset e buxhetimit afatmesem janë forcuar.</li> <li>1.3 Sherbimet publike të zgjedhura janë përmirësuar duke siguruar akses të barabartë për të gjithë qytetarët, përfshirë gratë dhe grupet e varfra apo të marginalizuara.</li> <li>1.4 Mekanizma novatorë të komunikimit dhe informacionit janë aplikuar nga NJQV-ja duke rritur transparencën dhe aksesin në informacion cilësor dhe shërbime për të gjithë qytetarët.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>2.1 “Qendrat e Kompetencës” janë identifikuar, praktikat e mira janë dokumentuar dhe shpërndare/ndarë me bashki dhe komuna të tjera në bashëpunim me Shoqatën e Bashkive (AAM) dhe Komunave (AAC)</li> <li>2.2. Shoqatat e forcuara (AAM dhe AAC) janë të afta të përfaqësojnë interesat e qeverisë lokale : procese konsultimi në ligj dhe berjen e politikave, ngritja e kapaciteteve për NJQV ndikon efektivisht në zbatimin e reformës së decentralizimit.</li> <li>2.3 Praktika e mire dhe ekspertiza e zgjedhur kontribuon në dialogun mbi politiken kombëtare.</li> <li>2.4 Sigurohet lidhja dhe shkëmbimi me programe dhe projekte në veçanti me Këshillin e Evropës .</li> </ul>

1.5 Qarku kontribuon ne rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit midis NJQV-ve.

**1.5 Një Vështrim mbi Gjetjet dhe Rekomandimet e Rishikimit të Fundit të Programit**

Rishikimi i fundit i programit u krye nga dy eksperte te jashtme (Lena Krylova dhe Ornela Shapo) ne tetor 2011. Gjetjet, rekomandimet dhe mesimet e nxjerra mund te pershkruhen si me poshte:

Përfundimet e Synuara	<b>1:</b> Bashkitë dhe Komunitet në qarkun Shkodër dhe Lezhë kanë përmirësuar strukturat qeverisëse, kapacitetet dhe shërbime publike të caktuara	<b>2:</b> Praktika të mira janë bërë të ditura në nivel kombëtar në bashkëpunim me shoqatat duke ndikuar kështu në ligj, vendimmarrje dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar
<b>Gjetje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Janë zhvilluar produkte cilësore dhe të konsultuara gjerësisht ;</li> <li>▪ Është siguruar zhvillimi i kapaciteteve relevante që i përgjigjet nevojave të veçanta të NJQV-ve;</li> <li>▪ Manuali i Grantit të dldp-se shërben si material mësimor për fondet të tjera në shumë drejtime;</li> <li>▪ Eshtë siguruar mbeshtetje e suksesshme për rrjetin e grave politike ne kontekstin e zgjedhjeve lokale (maj 2011) .</li> <li>▪ Dldp-ja eshte tepër e rëndësishme (pavarësisht mungesës së një kuadri të politikës së decentralizimit) dhe me përfundime të rëndësishme që i përgjigjen nevojave të veçanta të NJQV-ve, të cilat janë partnerët kryesorë të programit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dldp-ja është një projekt i mirënjohur;</li> <li>▪ Dldp-ja adreson një gamë të gjerë çështjesh tematike te rëndësishme;</li> <li>▪ Dldp-ja ka bashkëpunuar me sukses me shoqatat e NJQV-ve për t'i patur ato si aktorë me rëndësi në debatin e politikës së decentralizimit pavarësisht kontekstit të vështirë;</li> <li>▪ Koordinimi me projekte të tjera të SDC-së në të njëjtën fushë nuk ka qenë realizuar ende pavarësisht të qendrimit pro-aktiv të dldp-së</li> <li>▪ Konsultimi dhe harmonizimi me të tjera programe të bëhet kurdoherë që të jetë relevante.</li> </ul>
<b>Rekomandime</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të ngushtohet gjerësia tematike e programit në modelet e suksesshme,</li> <li>▪ Rritje të mëtejshme për efektivitet dhe ndikim të rritur duke konsideruar më mirë raportin kosto/efekte të mjeteve dhe paketave të mbështetjes,</li> <li>▪ Përcaktim i qartë i ndarjes së punës midis PZHR-së (programit të zhvillimit rajonal) dhe Dldp-së,</li> <li>▪ Sugjerim i përshkallëzimit të paketave të informacionit dhe komunikimit dhe</li> <li>▪ Përmirësim i sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit të dldp-së.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të përcaktohen kanale të qarta të përshkallëzimit të produkteve të dldp-së,</li> <li>▪ Të rritet pronësia e produkteve/paketave nga grupet e interesit në nivel kombëtar, për të lehtësuar më tej shpërndarjen e produkteve dhe praktikave më të mira</li> <li>▪ Te vazhdohet me punën me shoqatat për zhvillimin e produkteve si dhe për përhapjen e tyre.</li> </ul>

## 2 OBJEKTI DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TEMATIK

### 2.1 Qëllimi i këtij ushtrimi

Ky paragraf jep nje kuader ne teresi per kete ushtrim, i cili ka per qellim te monitoroje dhe kapitalizojë arritjet e *dldp*-se ne nivel lokal:

- Produkti i ushtrimit (raporti) ka per qellim te kapitalizojë arritjet e *dldp*-se dhe te identifikojë problemet si nje mundesi per mbeshtetje te metejshme ne lidhje me paketen e aktiviteteve te *dldp*-se e mbeshtetje te Planifikimit Strategjik dhe Planifikimit Buxhetor Afatmesem (PSZH/PBA) duke u bazuar ne nje grup indikatorësh;
- Eshte nje vleresim tematik i ndikimit te programit per pasoje eshte nje plotesim i kuadrit logjik te *dldp*-se ose instrumentit tjetër te perdorur per monitorimin e programit (nga pikëpamja e ciklit te manaxhimit te projektit/programit – PCM);
- Indikatorët e propozuar jane marre nga kuadri logjik dhe jane pasuruar me te tjere, te konsideruar si te dobishem per raportimin, duke filluar me indikatorët e PEFA-s, te pershtatura per punen e *dldp*-se.

### 2.2 Një vështrim mbi fushat e vlerësuara të projektit dhe indikatorët

#### 2.2.1 Vërejtje te përgjithshme lidhur me situatën aktuale në qeverisjen lokale dhe *dldp*-në

Duke folur nga pikëpamja strategjike, përqasja qe *dldp*-ja ka zgjedhur eshte teper ambicioze dhe perfshirese sepse prek shume dimensione te fushes se manaxhimit te financave publike si:

- buxhetimin me orientim strategjik,
- kombinimin e planifikimit financiar me ate te planifikimit te politikave,
- planifikimin e detajuar afatmesem,
- programimin gjithëperfshires dhe
- manaxhimin e performances.

Duke patur parasysh kontekstin dhe stadin aktual te manaxhimit te financave publike ne Shqiperi, ky trajtim eshte teper sfidues, keshtu qe ne menyre qe te ndertohet nje fryme dhe mbeshtetje lokale, rritja e kapaciteteve si nga pikepamja institucionale ashtu dhe ajo e njohurive ka rendesi strategjike.

Ne terma te instrumenteve konkrete te menaxhimit te financave publike dhe strategjike, *dldp*-ja mbeshteti zhvillimin dhe aplikimin e tre instrumenteve:

- planet strategjike te zhvillimit (PSZH),
- buxhetet afatmesme, duke perdorur klasifikimin e programeve me orientim nga performanca (PBA) dhe
- nje Instrumen te planifikimit financiar (IPF).

Nga pikepamja e implikimeve organizative te fushave qe mbeshtet *dldp*-ja, eshte me vlere qe te theksohet se nuk ka rruge tjetër perveç konsiderates ne teresi, sepse askush nuk mund te vere ne jete nje perqasje te tille strategjike dhe te mos projektoje procese organizative, struktura, role dhe pergjegjesi organizative ne te njejten kohe qe shkojne me perqasjen ne fjale. Duke patur parasysh kufizimet mbi burimet e NJQV-ve (ligjore, humane dhe financiare) ne Shqiperi, siç u trajtua ne seksionet e meparshme, programi ka synuar:

- te rrise ekspertizen dhe arrije konsensusin brenda NJQV-ve ne rajonin e Shkodres dhe te Lezhes sa me teper qe te jete e mundur,
- te rrise ndikimin e tij ne nivel kombetar nepermjet shtrirjes se arritjeve (role dhe procedura administrative, produkte, mjete, raporte, verejtje) ne shkalle kombetare
- per te arritur konsensus politik per reformen e metejshme qe nevojitet ne procesin e decentralizimit si nje menyre e heqjes se pengesave per zhvillimin organizativ.

Duke patur parasysh, procesin e reformes ne nje mjedis te veshtire, *dldp*-ja ka perdorur nje perqasje te kombinuar te qasjeve se pari dhe te mesuarit nepermjet praktikës se instruktuar ne procesin e reformes se manaxhimit te financave publike ne NJQV-te partnere.

2.2.2 Përfundimet e Synuara dhe Rezultatet e Pritura të dldp-së në fazën e II

Përfundime të synuar	Rezultatet e Pritura
<p><b>Përfundimi i synuar 1:</b> Bashkitë dhe Komunat në qarkun Shkodër dhe Lezhë kanë përmirësuar strukturat qeverisëse, kapacitet dhe shërbime publike të caktuara</p>	<p>Paketa e plotë e mbështetjes ne PSZH/PBA është pilotuar në 5 NJQV, IPF është pilotuar në 5 NJQV dhe në një NJQV PSZH/PBA është monitoruar përsa i përket konsideratës së përfshirjes shoqërore.</p>
	<p>50 anëtarë të tre grupeve të ekspertëve (SWM, PSZH/PBA dhe PCM) janë trajnuar si trajnerë dhe 10 prej tyre përdorin këto aftësi si resurse në trajnime/sesione të NJQV nëpër Qarqe</p>
	<p>Të tjera NJQV – brenda rajonit dhe mundësisht jashtë rajonit të projektit – janë të interesuara dhe NJQV-te e përzgjedhura aplikojne produktet dhe metodat e dldp-se</p>
	<p>Eshtë zbatuar koncepti i dldp-se për SWMP, i ripërdorur në 3 raste (rrjeti i NJQV-ve, kompostimi dhe riciklimi) dhe të gjitha NJQV-te kanë marrë trajnimin bazë në konceptet e SWM</p>
	<p>Konsolidimi i planeve të SWM mbështet politikat në plan kombëtar</p>
	<p>10-12 NJQV janë mbështetur nëpërmjet skemës së dldp-se për grante me mbi 70'000 përfitues në përmirësim të shërbimeve lokale</p>
	<p>Paketat PSZH/PBA, planet e administrimit të mbetjeve dhe skemat e aplikimit përfshijnë një vëmendje të veçantë për organizatat e komunitetit dhe pjesëmarrjen e sektorit privat</p>
	<p>Mbështetja specifike për të varfrit dhe të marginalizuarit është një kriter për projektet grant</p>
	<p>Nje platformë elektronike informacioni ndërtohet në çdo qark në mënyrë që te forcohet roli i tyre koordinues për NJQV-te</p>
	<p>Projektet qe përfshijnë disa NJQV mbështeten dhe dokumentohen</p>
<p><b>Përfundimi i synuar 2:</b> Praktika të mira janë bërë të ditura në nivel kombëtar në bashkëpunim me shoqatat duke ndikuar kështu ne ligj, vendimmarrje dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar</p>	<p>Konkurrimi i praktikave me te mira kontribuon ne shkëmbimet dhe përhapjen e praktikave më të mira (identifikimi dhe përhapja e praktikave lokale dhe rajonale më të mira në PSZH/PBA , SWM, bashkëpunimi midis NJQV-ve dhe PCM)</p>
	<p>Të tre grupet e ekspertëve ndërvendorë (PSZH/PBA, SWM dhe PCM) takohen rregullisht dhe sigurojnë inpute për tavolinat e rrumbullakëta, produktet etj duke kontribuar kështu në shkëmbimet dhe dialogun mbi politikat</p>
	<p>Një sere kriteresh për integrimin lokal të PSZH në planifikimin rajonal/kombëtar janë pranuar nga Qarqet/DEBASKON-i dhe MB duke kontribuar në Sistemin e Planifikimit te Integruar (PSI)</p>
	<p>Produket e dldp-se pranohen si relevante për debatet mbi politikat</p>
	<p>Kurrikulat e PSZH/PBA janë rishikuar, publikuar, përhapur dhe zbatuar</p>
	<p>Kurrikulat për manaxhimin e mbetjeve janë publikuar dhe manuali “Si të organizohet mbledhja e mbetjeve” është konsoliduar, pranuar dhe shpërndarë në konferencën kombëtare</p>
	<p>Një material mbi politiken dhe rolin e Qarkut ne manaxhimin e mbetjeve hartohet me ndihmën e përfaqësuesve të Qarkut dhe NJQV-ve dhe prezantohet në konferencën kombëtare</p>
	<p>Jepet çmimi i projektit më të mirë PCM dhe publikohet një katalog me grantet e projekteve duke përfshirë dhe mësimet e nxjerra</p>
	<p>Hartohet një kurrikul PCM ndërNJQV në koordinim të ngushtë me Qarqet nëse do të ketë kërkesë</p>
	<p>Mekanizmat dhe mësimet e nxjerra mbi transferimin e fondit kombëtar pranohen si praktika të mirë nga të gjithë donatorët.</p>
	<p>Një marrëveshje standard ndërNJQV për prokurimet është hartuar dhe pranuar nga APP</p>
	<p>Një seri e iniciativave kombëtare të mbështetura nga dldp-ja, tavolinat e rrumbullakëta dhe sesionet që kontribuojnë në dialogun mbi politikat në fushat kryesore të programit (PSZH/PBA ) si dhe një konference finale me mësimet e nxjerra ne fund të fazës II</p>
	<p>Rrjeti rajonal i “grave në politikë” dhe lidershipi promovohen në nivel rajonal dhe kombëtar në bashkëpunim të ngushtë me OSBE-ne</p>
	<p>Shoqatat e qeverisjes lokale janë të përfshira ngushtë në programet e aktiviteteve të dldp-se dhe në zhvillimin e produkteve te tij</p>
	<p>Mbështetja e orientuar nga kërkesa për zhvillim të mëtejshëm dhe pozicionimi i shoqatave të pushtetit lokal sigurohet duke u bazuar në plane pune të aprovuara</p>
<p>Produktet e dldp-se dhe mësimet e nxjerra pranohen dhe riprodhohen në koordinim me të tjera programe, donorë, ministritë e linjës dhe agjencitë qeveritare.</p>	

### 2.2.3 Lista e indikatorëve, metodologjia e vlerësimit dhe domethënia e saj

Ne mënyre qe te sigurohej një vlerësim tematik i progresit te dldp-se ne fazen II ne lidhje me komponentin e PSZH/PBA u perdoren nje sere indikatorësh. Nje liste e plote e tyre dhe metodologjia e vlerësimit jepet ne aneksin 1. Qellimi ishte te ndertohej nje baze krahasimi kurdo qe te ishte e mundur, te merrej nje pamje e situates aktuale dhe te vleresohej ndikimi i programit ne menyre qe te informohet dhe te kompletohet kuadri logjik per qellime monitorimi ne fund te programit.

Perfundimet e synuara	Domethënia	Indikatorët
<b>Përfundimi i Synuar 1:</b>  Bashkitë dhe Komunat në qarkun Shkodër dhe Lezhë kanë përmiresuar strukturat qeverisëse, kapacitet dhe shërbime publike të caktuara	Buxhetet e mbeshtetura ne Politika	IP-1: Numri i projekteve strategjike ne plan buxhetet vjetore dhe planet strategjike IP-2: Pjesa relative e projekteve strategjike ne plan buxhetet vjetore
	Parashikueshmeria e buxheteve	IP-3 : Devijimi i pergjithshem i shifrave ne plan buxhetet vjetore nga ato ne PBA ne lidhje me shpenzimet IP-4: Devijimi i pergjithshem i shifrave ne plan buxhetet vjetore nga ato ne PBA ne lidhje me të ardhurat IP-5 : Devijimi i programeve te shpenzimeve siç planifikohet ne plan buxhetet vjetore ne raport me PBA.
	Planifikimi dhe buxhetimi transparent dhe me pjesemarrje	IP-6: Disponueshmeria e informacionit per buxhetin IP -7: Pjesëmarrja ne planifikimin strategjik IP -8: Pjesemarrja ne krijimin e PBA IP -9: Komunikimi ne lidhje me informacionin mbi buxhetin
	PSZH te integruara vertikalisht	IP-10: Sa shume PSZH reflektojne mundesite dhe kufizimet e planeve rajonale dhe kombetare per NJQV?
	Kapacitete të rritura në NJQV për PSZH/PBA	IP-1: Numri i zyrtarëve të NJQV-ve dhe anëtareve të Këshillit te trajnuar në PSZH/PBA IP-12: Numri i NJQV-ve të trajnuara në PSZH/PBA IP-13: Numri i NJQV-ve te instruktuar në PSZH dhe përqindja e zyrtareve të NJQV-ve të përfshira IP -14: Numri i NJQV-ve të instruktuar në PBA dhe përqindja e zyrtareve të NJQV-ve të përfshira IP-15: Numri i NJQV-ve të instruktuar në aplikimin e IPF dhe përqindja e zyrtarëve të përfshirë
	Prani e rritur e PSZH/ PBA në NJQV	IP-16: PSZH të reja te krijuara IP-17: PSZH të përditësuara IP-18: A i respektojne PBA e prodhuara ne NJQV-te e qarkut Shkoder dhe Lezhe rekomandimet e dldp-se? IP-19: IPF versioni final IP-20: PBA të krijuar duke përdorur IPF

Perderisa kjo fushe e mbeshtetjes, sidomos ajo nen Përfundimin e Synuar 1, eshte e lidhur ngushte me praktikat e manaxhimit te financave publike, ne diskutim me ekspertin nderkombetar qe zbaton projektin dhe njesine e manaxhimit te projektit (NJMP) u ra dakort qe indikatorët me te pershtatshem per kete vleresim do te ishin lista e indikatorëve PEFA te pershtatur per aktivitetet e dldp-se si me poshte:

- Buxheti vjetor eshte me i orientuar nga pikëpamja strategjike qe i korrespondon indikatorëve të buxhetimit te politikave ne listen PEFA;
- Shperndarja e burimeve eshte me e parashikueshme qe i korrespondon indikatorëve te parashikueshmerise se buxheteve ne listen PEFA ;
- Burimet jane te shperndara ne menyre me transparente dhe me pjesemarrjen e publikut qe i korrespondon indikatorëve te transparences dhe pjesemarrjes ne procesin e planifikimit dhe buxhetimit ne listen PEFA.
- Perveç ketyre u perdoren dhe indikatorët te tjere sidomos per te vleresuar shkallen e integritit vertikal te PSZH ne NJQV ne planet strategjike rajonale dhe kombetare.

Vleresimi u krye duke kombinuar studimin e materialeve dhe rezultatet e pergjigjeve te pyetesoreve qe iu shperndane NJQV-ve, objekt i veprimtarisë se programit ne Qarkun e Lezhes dhe Shkodres. Nje kopje e pyetesorit mund te gjendet ne Aneksin 2. Perveç kësaj, eksperti vleresues dhe oficeri pergjegjes (OP) nga dldp-ja moren pjese ne diskutimet ne tryezë të rrumbullaket me perfaqesues te NJQV-ve per te shpjeguar qellimin dhe objektin e vlerësimit.

Ne seksionet e mëtejshme, jepet nje shpjegim i detajuar per çdo indikator ne nivel NJQV-je, subjekt i mbështetjes së dldp ne fazen II duke u bazuar ne informacionin e disponueshem deri me tani. .



### 3 SHQYRTIMI I DETAJUAR DHE GJETJET KRYESORE

#### 3.1 Përfundimi i Synuar 1: Bashkitë dhe Komunat në rajonin e Shkodrës dhe te Lezhës kanë përmirësuar strukturat, kapacitetet qeverisëse, dhe shërbimet e zgjedhura publike.

##### 3.1.1 Buxhetet e mbështetura në Politika

Indikatorët nën këtë titull kanë si fokus këndvështrimin afatgjatë gjatë procesit buxhetor të NJQV-se. Me kalimin e kohës ajo që çdokush do të prishte do të ishte një rritje e rëndësishme të shpenzimeve të planifikuara afatgjatë d.m.th një rritje në numër dhe buxhet për projektet afatgjatë në rrugën e konsolidimit fiskal. Pamja që tregojnë indikatorët e matur më poshtë është më e larmishme se kaq. Mund të shihet që ndërsa numri i projekteve strategjike është në rritje në NJQV, objekti i vlerësimit, pjesa respektive që ato zënë në buxhet është rritur me shpejtësi më të vogël. Dy arsye kryesore mund të parashtrihen për këtë situatë :

- pjesa më e madhe e transfertave të pakushtezuara, që mbulojnë më së shumti projektet afatgjatë, për NJQV pas vitit 2009, është përqendruar në Fondin e Zhvillimit Rajonal, për pasojë NJQV-te nuk janë komplet autonome në procesin e vendimmarrjes të lidhur me projektet në fjalë;
- burimet financiare të NJQV-ve gjatë 2009-2012 kanë qenë subjekt i një paparashikueshmërie të lartë përderisja varen kryesisht nga volumi i transfertave të kushtezuara dhe të pakushtezuara nga QSH, e cila nën presionin e të ardhurave të uleta për shkak të uljes së ritmeve të rritjes ekonomike, ka rishikuar në mënyrë konsistente të gjitha shpenzimet e planifikuara me qëllim uljen e tyre.

Mbajtja e një këndvështrimi afatgjatë në procesin e buxhetimit është një gjë me shumë vlerë pasi ka gjasa të promovojë stabilitetin financiar dhe cilësinë e sigurimit të shërbimeve publike, për pasojë dldp-ja duket se ka luajtur një rol të rëndësishëm këtu. Megjithatë, situata tregon që ka nevojë për një parashikim më të mirë të të ardhurave në PBA sidomos për të ardhurat e veta. Cilado përpjekje që rrit sasinë e këtyre të ardhurave duhet të promovohet në fazën e ardhshme të programit duke përfshirë dhe artikullimet për mbrojtjen e një mase të caktuar të granteve të kushtezuara dhe të pakushtezuara që kanë të bëjnë me funksione të rëndësishme në nivel lokal.

**Tabela e IP-1: Shqyrtimi i numrit të projekteve strategjike në plan buxhetet vjetore.**

NJQV	2010	2011	2012	2013	Devijimi 2011-2010	Devijimi 2012-2010	Devijimi 2013-2010	Progres P Jo Progres np
Baldreni	0	0	0	5	0	0	5	P
Bushati	2	3	4	5	1	2	3	P
Dajç Bregu i Bunes	1	2	4	2	1	3	1	np
Fushe Arrezi	13	9	10	5	-4	-3	-8	np
Kallmeti	0	12	15	16	12	15	16	P
Lezha	0	0	0	0	0	0	0	np
Puka	0	0	7	11	0	7	11	P
Rubiku	2	2	1	0	0	-1	-2	np
Shkreli	8	5	7	13	-3	-1	5	P
Vau i Dejes	8	4	3	5	-4	-5	-3	np
Velipoja	6	7	3	10	1	-3	4	P
<b>Shkalla e Progresit</b>								<b>66%</b>

Burimi: Përgjigjet e pyetësoreve nga NJQV

**Tabela e IP-2: Shqyrtimi i pjesës relative të projekteve strategjike në plan buxhetet vjetore**

NJQV	2010	2011	2012	2013	Devijimi 2011-2010	Devijimi 2012-2010	Devijimi 2013-2010	Progres P Jo Progres np
Baldreni	0	0	0	0	0	0	0	np
Bushati	55	51	21	30	-4	-34	-25	np
Dajç Bregu i Bunes	0	15	6	0	15	6	0	np
Fushe Arrezi	21	35	64	78	14	43	57	P
Kallmeti	15	16	14	10	1	-1	-5	np
Lezha	25	27	30	30	2	5	5	P
Puka	11	12	80	78	1	69	67	P
Rubiku	0	0	0	0	0	0	0	np
Shkreli	30	25	30	40	-5	0	10	P
Vau i Dejes	16	11	0.6	0.6	-5	-15.4	-15.4	np
Velipoja	42	55	8	38	13	-34	-4	np
<b>Shkalla e Progresit</b>								<b>40%</b>

Burimi: Përgjigjet e pyetësoreve nga NJQV

### 3.1.2 Parashikueshmeria e buxheteve

Indikatorët nën këtë titull tregojnë cilësinë e planifikimit të buxhetit në përgjithësi. Ato janë adaptuar nga treguesit PEFA me rezervën e pershtatjes së aktualit (shpenzime dhe të ardhura) për të paraqitur shpenzimet/të ardhurat e planifikuara vjetore dhe planin (shpenzime ose të ardhura) për shpenzimet/të ardhurat e planifikuara në PBA.

Dy vërejtje që duhet t'u kushtohet vëmendje që në fillim janë:

- Devijimi në shpenzime dhe të ardhura janë ekzaktesisht të njëjta për këto NJQV për shkak të faktit që NJQV-të janë të detyruara defacto të planifikojnë shpenzimet për të ardhurat e planifikuara përderisa nuk kanë patur mundësi të marrin borxh në të kaluarën: kufiri i 60% i PPB është arritur i gjithi nga borxhi qendror publik, kështu që s'ka patur hapësirë për borxh lokal.
- **IP-5 i cili ka të bëjë me devijimin e programeve të shpenzimeve siç planifikohet në plan buxhetet vjetore në raport me PBA** është e pamundur që të matet aktualisht, sepse klasifikimi programatik i shpenzimeve në PBA është i ndryshëm nga ai i përdorur në plan-buxhetet vjetore dhe i pastandardizuar në të gjitha NJQV-të apo në pershtatje me klasifikimin programatik të përdorur nga MF. Si një alternativë u kerkua të përdorej klasifikimi funksional por edhe këtu struktura e plan buxheteve vjetore dhe PBA kishin mosperputhje për pasojë nuk mund të bëhet një matje me kuptim e këtij indikator për momentin.

Në përgjithësi, nga sa mund të shihet nga indikatorët e matur, mund të vihet re që megjithatë devijimet mesatare janë rritur ngadalë gjatë 2010-2012, ka nga ato NJQV që kanë arritur t'i ulin edhe pse ato mbeten ende larg niveleve të mira të manaxhimit të financave publike. Nga këto të fundit, tre NJQV në këto total kanë qenë mbështetur nga *ddp*-ja, gjë që tregon qartë ndikimin e programit dhe potencialin për përmirësim nga mundësia e shtrirjes së programit në të tjera NJQV. Në vazhdim të kësaj, adoptimi i standardeve kombëtare në klasifikim dhe paraqitje do të rriste mundësinë për sinergji me projekte të ngjashme kombëtare dhe potencialin për përhapje në të tjera NJQV.

**Tabela e IP-3: Shqyrtimi i devijimit të përgjithshëm të shifrave në plan buxhetet vjetore nga ato në PBA në lidhje me shpenzimet**

NJQV	Shpenzime 2011 PBA	Shpenzime 2011 BG Vjetor	Shpenzime 2013 PBA	Shpenzime 2013 BG Vjetor	Devijimi 2011	Devijimi Përqindje	Devijimi 2013	Devijimi Përqindje	Progres P Jo Progres np
Baldreni	72535	81335	106898	33935	8800	12%	-72963	68%	np
Bushati	65092	41518	78920	42770	-23574	36%	-36150	46%	np
Fushe Arrezi	33625	51728	178528	148147	18103	54%	-30381	17%	P
Kallmeti	20842	20439	22454	22933	-403	2%	479	2%	p
Puka	47309	45459	212357	212357	-1850	4%	0	0%	P
Rubiku	17154	38649	16688	36226	21495	125%	19538	117%	np
Shkreli	21764	26317	24735	37247	4553	21%	12512	51%	np
Vau i Dejes	96663	57455	61095	60992	-39208	41%	-103	0%	P
Velipoja	89173	76056	104957	152000	-13117	15%	47043	45%	np
Mesatare						34%		38%	
Shkalla e Progresit									44%

Burimi: Përgjigjet e pyetësoreve nga NJQV, PBA dhe plan buxhetet vjetore të dorëzuara prej NJQV (Shifrat në mijë leke)

**Tabela e IP-4: Shqyrtimi i devijimit të përgjithshëm të shifrave në plan buxhetet vjetore nga ato në PBA në lidhje me të ardhurat**

NJQV	Ardhura 2011 PBA	Ardhura 2011 BG Vjetor	Ardhura 2013 PBA	Ardhura 2013 BG Vjetor	Devijimi 2011	Devijim Përqindje	Devijim 2013	Devijim Përqindje	Progres P Jo Progres np
Baldreni	72535	81335	106898	33935	8800	12%	-72963	68%	np
Bushati	65092	41518	78920	42770	-23574	36%	-36150	46%	np
Fushe Arrezi	33625	51728	178528	148147	18103	54%	-30381	17%	P
Kallmeti	20842	20439	22454	22933	-403	2%	479	2%	P
Puka	47309	45459	212357	212357	-1850	4%	0	0%	P
Rubiku	17154	38649	16688	36226	21495	125%	19538	117%	np
Shkreli	21764	26317	24735	37247	4553	21%	12512	51%	np
Vau i Dejes	96663	57455	61095	60992	-39208	41%	-103	0%	P
Velipoja	89173	76056	104957	152000	-13117	15%	47043	45%	np
Mesatare						34%		38%	
Shkalla e Progresit									44%

Burimi: Përgjigjet e pyetësoreve nga NJQV, PBA dhe plan buxhetet vjetore të dorëzuara prej NJQV (Shifrat në mijë leke)

### 3.1.3 Planifikimi dhe buxhetimi transparent dhe me pjesëmarrje

Indikatorët nën këtë titull kapin faktorët dhe shkallën e pjesëmarrjes së publikut në procesin e buxhetit, me saktësi në procesin e përgatitjes së tij si mëse e transparencës dhe përgjegjshmërisë në sistemin

lokal te manaxhimit te financave publike. Eshte per tu shenuar qe nuk ka informacion qe do te na mundesonte te matim kete indikator ne fillimin e programit per te dhene nje ide mbi progresin/regresin e situates, per rrjedhoje ky vleresim sherben per te ndertuar per here te pare bazen krahasuese.

Pavarësisht se nje vleresim i progresit te impaktit te programit nuk mund te dokumentohet ne nje menyre te pranueshme, ka disa gjetje qe mund te perdoren per drejtimin e punes ne te ardhmen persa i takon ketij dimensionin ne sistemin lokal te manaxhimit te financave publike.

**Tabela e IP-6 : Shqyrtimi i disponueshmerise se informacionit për buxhetin.**

NJQV	2010		2013		Progres P Jo Progres np
	Disponueshmëria e Dokumentave të Buxhetit	Vlerësimi	Disponueshmëria e Dokumentave të Buxhetit	Vlerësimi	
Baldreni	n.a.	n.a.	5 out of 6	B	na
Bushati	n.a.	n.a.	6 out of 6	A	na
Dajç Bregu i Bunes	n.a.	n.a.	4 out of 6	C	na
Fushe Arrezi	n.a.	n.a.	5 out of 6	B	na
Kallmeti	n.a.	n.a.	6 out of 6	A	na
Lezha	n.a.	n.a.	6 out of 6	A	na
Puka	n.a.	n.a.	6 out of 6	A	na
Rubiku	n.a.	n.a.	4 out of 6	C	na
Shkreli	n.a.	n.a.	4 out of 6	C	na
Vau i Dejes	n.a.	n.a.	5 out of 6	B	na
Velipoja	n.a.	n.a.	5 out of 6	B	na
<b>Shkalla e Progresit</b>					na

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV

Nga sa mund te shihet, situata eshte e mire ose shume e mire ne terma te disponueshmerise se buxhetit ne 70% te NJQV kurse per pjesen e mbetur te 30% kerkohej Përmirësim. Megjithate, gjeja me e rendesishme per te mundesuar nje pjesemarrje efektive, eshte sigurimi i informacionit cilesor, i cili nga pergjigjet e pyetesoreve duket se mungon ende. Informacioni i tille si supozimet makroekonomike te rritjes ekonomike ne rajon, faktoret qe ndikojne ne te ardhurat dhe shpenzimet ende mungojne ne shumicen e NJQV-ve te pyetura.

**Tabela e IP-7: Shqyrtimi i grupeve te interesit qe marrin pjese ne planifikimin strategjik te zhvillimit**

NJQV	2010		2013		Progres P Jo Progres np
	Pjesmarrja në Planifikimin Strategjik të Zhvill	Vlerësimi	Pjesmarrja në Planifikimin Strategjik të Zhvill	Vlerësimi	
Baldreni	n.a.	n.a.	72%	A	na
Bushati	n.a.	n.a.	100%	A	na
Dajç Bregu i Bunes	n.a.	n.a.	50%	B	na
Fushe Arrezi	n.a.	n.a.	60%	B	na
Kallmeti	n.a.	n.a.	50%	B	na
Lezha	n.a.	n.a.	60%	B	na
Puka	n.a.	n.a.	50%	B	na
Rubiku	n.a.	n.a.	20%	D	na
Shkreli	n.a.	n.a.	10%	D	na
Vau i Dejes	n.a.	n.a.	10%	D	na
Velipoja	n.a.	n.a.	30%	C	na
<b>Shkalla e Progresit</b>					na

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV

Situata e mire dhe shume e mire ketu eshte e pranishme ne 65% te NJQV, e cila eshte e krahasueshme me indikatorin e meparshem. Megjithate dhe ne vazhdim te verejtjes se meparshme, nje gjetje e rendesishme ketu ka te beje me nivelin e ulet te pjesemarrjes te autoriteteve rajonale, gje qe tregon per nje nivel te ulet koordinimi midis nivelit te ulet dhe te mesem te qeverisjes rajonale. Perderisa fokusi ketu eshte planifikimi strategjik, dldp-ja t'i kushtojte me teper perpjekje ketij koordinimi sepse ka rendesi te madhe per te permirësuar gjasat e pergatitjes se projekteve/planeve strategjike ne nivele te uleta.

**Tabela e IP-8: Shqyrtimi i grupeve te interesit qe marrin pjese ne procesin e krijimit te PBA**

LGUs	2010		2013		Progres P Jo Progres np
	Pjesmarrja në PBA	Vlerësimi	Pjesmarrje në PBA	Vlerësimi	
Baldreni	n.a.	n.a.	100%	A	na
Bushati	n.a.	n.a.	64%	B	na
Dajç Bregu i Bunes	n.a.	n.a.	50%	C	na
Fushe Arrezi	n.a.	n.a.	73%	B	na
Kallmeti	n.a.	n.a.	73%	B	na
Lezha	n.a.	n.a.	73%	B	na
Puka	n.a.	n.a.	82%	B	na
Rubiku	n.a.	n.a.	82%	B	na
Shkreli	n.a.	n.a.	45%	C	na
Vau i Dejes	n.a.	n.a.	64%	B	na
Velipoja	n.a.	n.a.	27%	D	na
<b>Shkalla e Progresit</b>					<b>na</b>

Burimi: Pergjigjet e pyetesoreve nga NJQV

Ndersa pjesëmarrja e mire eshte e pranishme ne shumicen e NJQV-ve, rezultatet e dobeta mund te shpjegohen po ashtu me mungesen e niveleve te veçanta te funksioneve qeverisese ne nivel lokal per shkak te shtrëngesave buxhetore ne periudhen e ngadalesimit ekonomik. Gjithesesi, duke iu referuar dhe vlerave te **IP-3** dhe **IP-4**, dldp-ja ka nevojë t'i kushtojë një vemendje te rritur pjesëmarrjes efektive te ketyre funksioneve ne menyre qe te prodhohen PBA realiste. Aktivitetet e ngritjes se kapaciteteve nga programi ne kete drejtim jane pra te justifikuar dhe po i tille eshte dhe perdorimi i IPF dhe aktivitetet qe i kushtohen rritjes se perdorimit te tij ne pjesen e mbetur te NJQV-ve dhe mundesisht dhe ne NJQV te tjera te rajonit te Shkodres dhe Lezhes.

**Tabela e IP-9: Shqyrtimi i kanaleve te komunikimit te informacionit buxhetor per publikun**

NJQV	2010		2013		Progres P Jo Progres np
	Kanalet e Komunikimit	Vlerësimi	Kanalet e Komunikimit	Vlerësimi	
Baldreni	n.a.	n.a.	5 channels	B	na
Bushati	n.a.	n.a.	6 channels	A	na
Dajç Bregu i Bunes	n.a.	n.a.	5 channels	B	na
Fushe Arrezi	n.a.	n.a.	5 channels	B	na
Kallmeti	n.a.	n.a.	3 channels	C	na
Lezha	n.a.	n.a.	5 channels	B	na
Puka	n.a.	n.a.	6 channels	A	na
Rubiku	n.a.	n.a.	4 channels	C	na
Shkreli	n.a.	n.a.	1 channel	D	na
Vau i Dejes	n.a.	n.a.	4 channels	C	na
Velipoja	n.a.	n.a.	5 channels	B	na
<b>Shkalla e Progresit</b>					<b>na</b>

Source: Pyetsorët e plotësuar nga NjQV

Ne pergjithesi ka nje situatë te mire te komunikimit te informacionit te buxhetit nga NJQV-te drejt publikut. Rezultatet e dobeta shpjegohen gjithashtu dhe me mungesen e penetrimit te formave masive te komunikimit mediatik (internet dhe interneti vizual) ne disa nga NJQV-te qe ishin objekt i vleresimit. Ne te ardhmen mund te pritët qe ky indikator te permirësohet per shkak te shtrirjes se sherbimit te internetit te ofruar ne kuadrin e "Reformes se Moshes Dixhitale" ne te gjithe vendin. Dldp-ja duhet te perdore kete mundesi si nje baze per te zgjeruar arrijtet qe bien ne kuadrin e ketij indikatorit ne te ardhmen e afert.

### 3.1.4 PSZH të integruara vertikalisht

Indikatori i meposhtem perpiqet qe te kape qartesine dhe cilesine e PSZH ne procesin e planifikimit strategjik. Shpresohet qe me kalimin e kohes, NJQV-te te shfrytezojnë te gjitha mundesite qe jep mjedisi per te rritur gjasat e zhvillimit ne territorin e tyre. Pjese e ketyre mundesive jane gjithashtu dhe planet strategjike rajonale dhe kombetare, te cilat mund te sjellin efekte sinergjie per planet strategjike thjesht nepermjet pershtatjes se prioriteteve dhe objektivave.

Nga shqyrtimi i bere ne indikatore si me poshte mund te arrihet ne konkluzionin, qe megjithese te mire ne forme, planet PSZH kane nevojte te sigurojne me teper detaje te analizes te mundesive rajonale dhe kombetare ne linje me fuqite dhe dobesite ne nivel lokal. Ne nje NJQV progresi eshte i jashtezakonshem dhe eshte per tu theksuar qe nje pjese e atij progresi eshte realizuar drejtperdrejt me mbeshtetjen e dldp-se. Dokumenti perfshin jo vetem nje analize te plote SWOT por ka shkuar ne detaje te planeve dhe aktiviteteve dhe lidhjeve te tyre me PBA, gje qe rrit eficensen dhe lidhjen e dy proceseve per arritjen e rezultateve te planifikuara. Dldp-ja mund te kapitalizojte mbi pune te tilla dhe te siguroje mjete standarde si ne rastin e IPF per PBA ne menyre qe te sigurohen PSZH cilesore qe marrin parasysh mundesite rajonale dhe i perkthejne ato ne programe realiste dhe te arritshme aktivitetesh nepermjet lidhjes me PBA cilesore.

**Tabela e IP-10: Shqyrtimi se sa shume PSZH reflektojnë mundesite dhe kufizimet e planeve rajonale dhe kombetare per NJQV**

NJQV	Para 2010		2013		Progres P Jo Progres np
	PSZH të integruara vertikalisht	Vlerësimi	PSZH të integruara vertikalisht	Vlerësimi	
Baldreni	n.a.	n.a.	SDPs and PBAs	B	P
Bushati	n.a.	n.a.	SDPs and PBAs	B	P
Dajç Bregu i Bunes	SDPs and PBAs	B	SDPs and PBAs	B	np
Fushe Arrezi	SDPs and PBAs	C	SDP and PBAs	B	P
Kallmeti	SDPs and PBAs	C	SDP and PBAs	C	np
Lezha	SDPs and PBAs	D	SDP and PBAs	D	np
Puka	SDPs and PBAs	B	SDPs and PBAs	B	np
Rubiku	SDPs and PBAs	D	SDP and PBAs	D	np
Shkreli	n.a.	n.a.	SDPs and PBAs	A	P
Vau i Dejes	SDPs and PBAs	C	only PBAs	C	np
Velipoja	SDPs and PBAs	D	only PBAs	D	np
<b>Shkalla e Progresit</b>					<b>44%</b>

Burimi: PSZH te reja dhe te vjetra te dorezuara nga NJQV, PBA dhe informacion nga OP

### 3.1.5 Kapacitete të njohurive dhe kapacitete institucionale të përmirësuara për NJQV

Indikatorët me poshte perpiqen te arrijne punen e bere nga dldp-ja për te përmirësuar kapacitetet institucionale ne lidhje me PSZH dhe PBA. Ata kane te bejne me te dy aktivitetet e trajnimit dhe te instruktimit qe dldp-ja ka perdorur ne fazen II.

Rezultatet jane deri diku te perziera: mund te shihet qe rezultatet jane ne pergjithesi te mira ne shtrirje te aktiviteteve dhe perfshirjen e administrates publike gjithmone duke respektuar kriterin e gjinise. Eshte dukshme qe dldp-ja eshte shume ambicioze si program perderisa perpiqet qe te punoje ne shume drejtime: PSZH, PBA, procese, standarde dhe mjete si dhe ngritjen e kapaciteteve perkatese. Per nje vend me mjedis te stresuar, disa nga objektivat jane thjesht pertej kontrollit te manaxhimit te projektit, keshtu qe nje nivel i arritjes se objektivit prej 70-90 % duhet kualifikuar si i mire ne vend qe te kualifikohet i kenaqshem. Çfare eshte me e rendesishme eshte efektiviteti dhe ndikimi i programit ketu d.m.th masa ne te cilen programi ka ndikuar te NJQV-te per te arritur rezultate ne planifikimin financiar (ne afat te shkurter dhe te gjate). Eshte po ashtu e dukshme qe programi ka sjelle progres sidomos ne NJQV qe jane instruktuar siç tregohet dhe nga tabelat e meparshme dhe te meposhtme te shqyrtimit te indikatoreve. Eshte teper e rendesishme qe dldp-ja te zgjeroje shtrirjen e instruktimit ne mbështetje te NJQV-te ne programimin e ardhshem ne menyre qe te mbeshtese qendrueshmerine e rezultateve; po ashtu te ofroje sa me teper perpjekje qe te jete e mundur per te perhapur rezultatin ne nivel kombetar ne

menyre qe te krijohet nxitje dhe qendrim pozitiv per rezultatet e arritura. Ideja e mbeshtetjes dhe lobimit per nje PEFA ne nivel lokal do te ishte me vlere ketu.

**Tabela e Shqyrtimit te Indikatoreve per Ngritjen e Kapaciteteve nga IP 11-IP 15**

Ndërtimi i kapaciteteve në PSZH/PBA	2010-2011		2012		Shkalla e Arritjes së Objektivit 2010-2011	Shkalla e Arritjes së Objektivit 2012
	Numri Real	Objektivi i Kuad Logjik	Numri Real	Objektivi i Kuad Logjik		
Nr i Sesioneve të Trainimit	6	4	3	2	Arritje e Objektivit	Arritje e Objektivit
<b>IP 11</b> Numri i zyrtarëve të NJQV dhe anët të Këshillit te trainuar në PSZH/PBA	88 nga të cilët 35% femra	50% of zyrtarëve dhe anëtarëve të këshillit të NJQV d.m.th rreth 100; Femra më tepër se 30%	112 nga të cilët 48% femra	50% of zyrtarëve dhe anëtarëve të këshillit të NJQV d.m.th rreth 100; Femra më tepër se 30%	88% ne numër; Arritje e objektivit në gjini	Objektivi i arritur ne numër dhe ne gjini
<b>IP 12</b> Numri i NJQV të trainuar në PSZH/PBA	43	54	21	22	79%	95%
<b>IP 13</b> Numri i NJQV i instruktuar në PSZH dhe përqindja e zyrtareve të NJQV të përfshirës	Numri i NJQV=6 përqindja e përfshirjes më tepër se 50%	Numri i NJQV=9; 50% përqindja e përfshirjes	Numri i NJQV=8; 50% përqindja e përfshirjes	Numri i NJQV=11 dhe 50% përqindja e përfshirjes	66% në numër të NJQV; Objektivi i përfshirjes i arritur	63% në numër të NJQV; Objektivi i përfshirjes i arritur
<b>IP 14</b> Numri i NJQV të instruktuar në PBA dhe përqindja e Oficerëve të NJQV të përfshirë	Numri i NJQV=6 përqindja e përfshirjes më tepër se 50%	Numri i NJQV=9; 50% përqindja e përfshirjes	Numri i NJQV=7; Më tepër se 50% përqindja e përfshirjes	Numri i NJQV=11 dhe 50% përqindja e përfshirjes	66% në numër të NJQV; Objektivi i përfshirjes i arritur	60% në numër të NJQV; Objektivi i përfshirjes i arritur
<b>IP 15</b> Numri i NJQV të instruktuar në aplikimin e MPF dhe përqindja e zyrtarëve të përfshirë	Asnjë	Asnjë	Numri i NJQV=6 dhe më tepër se 50% përqindja e përfshirjes	Numri i NJQV=5 dhe 50% përfshirjes	N.a	Të dy objektivët të arritur

Burimi: Statistika te sesioneve te dorezuara nga OP dhe kuadri logjik i dldp-se

**3.1.6 Prani e shtuar e PSZH, PBA ne NJQV**

Mund te shihet nga indikatorët e meposhtem qe progres i mire kundrejt kuadrit logjik per 2010-2011 eshte shenuar me tej gjate vitit 2012 me hyrjen e IPF, i cili ka bere te mundur lidhjen midis objektivave strategjike te PSZH, programeve dhe aktiviteteve. Ne nje rast progresi ka qene i jashtezakonshem (rasti i Shkrelit) ne terma te cilesise se produktit te prodhuar. Kjo gje tregon qe strategjia e trajnimit dhe instruktimit per disa komuna ka qene efektive.

**Tabela e Shqyrtimit te PSZH te reja dhe te perditesuara per IP-16 dhe IP-17**

Prani e rritur e PSZH/PBA në NJQV	2010-2011		2012		Arritje e Objektivit 2010-2011	Arritje e Objektivit 2012
	Numër Real	Objektiv i K. Logjik	Numër Real	Objektiv i K. Logjik		
<b>IP 16</b> PSZH të krijuara	2	3	1	1	66%	100%
<b>IP 17</b> PSZH të përditësuara	4	6	5	5	66%	100%

Burimi: PSZH te reja dhe te vjetra te dorezuara nga NJQV, kuadri logjik i programit

Gjithesesi cilesia e PSZH-ve te perditesuara ka nevojë qe te permiresohet akoma me tej ne komunat e tjera dhe kjo kerkon kohe ne nje mjedis sfide si Shqiperia. Cilesia e PSZH ka nevojë te permiresohet vecanerisht nepermjet integritit te PSZH me PBA nepermjet shtrirjes se IPF ne komunat e tjera. Gjithashtu mund te synohet standardizimi i metejshem i mjeteve te perdorura per formulimin e PSZH me qellim rritjen e cilesise dhe permiresimin e mekanizmit te monitorimit te ketyre strategjive. Ka nevojë per vemendje po ashtu ndaj procesit te rishikimit dhe perditesimit te strategjive te tilla ne menyre qe te kete strategji qe evoluojne sipas nje mjedisi ne ndryshim.

**IP-18: A respektojnë PBA e prodhuara ne NJQV-te e qarkut Shkoder dhe Lezhe rekomandimet e dldp-se?**

Prani e rritur e PSZH/PBA në NJQV	Para 2010		2012		Progres P Jo Progres np
	PBA të dorëzuara para 2010	Vlerësim	PBA në fund të 2012	Vlerësim	
Baldreni	n.a.	n.a.	PBAs	A	P
Bushati	n.a.	n.a.	PBAs	A	P
Dajç Bregu i Bunes	PBAs	C	PBAs	A	P
Fushe Arrezi	PBAs	C	PBAs	A	P
Kallmeti	PBAs	C	PBAs	C	np
Lezha	PBAs	D	PBAs	D	np
Puka	PBAs	C	PBAs	A	np
Rubiku	PBAs	D	PBAs	D	np
Shkreli	PBAs	D	PBAs	A	P
Vau i Dejes	PBAs	C	PBAs	A	P
Velipoja	PBAs	D	PBAs	D	np
<b>Shkalla e Progresit</b>					<b>64%</b>

Burimi: PBA te vjetra dhe te reja te dorezuara nga NJQV, pergjigje nga pyetesoret

Si ne indikatorin paraardhes mund te shihet qe progresi ka qene i pranishëm per shkak te hyrjes se IPF dhe instruktimit te komunave. Cilesia e PBA eshte permirsuar si ne cilesi ashtu dhe ne substance: ato nuk jane me nje shpallje e thjeshte tavanesh buxhetore por ka nje avancim kundrejt grupimit te shpenzimeve ne programe me qellime dhe objektiva te qarta. Shtrirja e kesaj pune ne te tjera komuna do te ishte e deshirueshme me shenimin ka nje nevojë per te vazhduar drejt standardizimit te klasifikimit dhe paraqitjes formale te programit ne linje me metodologjine e klasifikimit te perdorur nga MF ne menyre qe te lehtesohet raportimi, monitorimi dhe krahasueshmeria midis rajoneve. Ky standardizim do te permirësoje mundesine e perphapjes ne komuna te tjera dhe gjasat e mbeshtetjes nga autoritetet kombetare ne kete proces.

**Tabela e Shqyrtimit te IP-19 dhe IP-20 per disponueshmerine dhe perdorimin e IPF**

Prani e rritur e PSZH/PBA në NJQV	2012-2013		Arritja e Objektivit 2013
	Situata Aktuale	Objektivi i K. Logjik	
<b>IP 19 MPF versioni final</b>	Në përdorim	Shkurt 2013	<b>Arritur</b>
<b>IP 20 PBA të krijuar duke përdorur MPF</b>	5 NJQV	5 NJQV	<b>Arritur</b>
<b>Progress Scale</b>			<b>100%</b>

Burimi: PBA te vjetra dhe te reja te dorezuara nga NJQV

Dy indikatorët e mbetur te shpjeguar ne kete table janë veteshpjegues dhe nuk ka koment tjetër përveç faktit qe arritja e objektivit është bere ne perputhje me indikatorët ne program dhe kuadrin logjik.

### 3.2 Shqyrtimi i Impaktit të Programit

Ky vlerësim nuk është nje vlerësim final teresor, por siç u tha qe ne fillim është nje vlerësim tematik, për pasojë vlerësimi i ndikimit është ne raport me vlerësimin e bere për perfundimet e synuara, me saktësiht perfundimit te synuar 1.

Programi ka qene teper ambicioz perderisa aktivitetet janë fokusuar ne shume zona te manaxhimit strategjik dhe sistemin lokal te manaxhimit te financave publike te lidhura me te. Eshte e vertete qe programi nisi ne nje periudhe ekspansioni ekonomik me norma te larta rritjeje ekonomike ne vend. Eshte shume me e lehte te zhvillosh veprime/trajtime strategjike dhe te motivosh mbeshtetjen e autoriteteve lokale ne periudhen e ekspansionit ekonomik ne vend te periudhave te ngadalësimit ku ka nje nevojë urgjente për te perballuar realitetin e nevojave te perditeshme te administrates publike ne vend qe te mendohet për nevoja strategjike. Kjo ka qene nje sfide qe programit i është dashur ta perballoje; nga perspektiva e Ciklit te Menaxhimit te Projektit, duket qe manaxhimi i programit ka qene i ndergjegjishem për kete nepermjet supozimeve dhe masave te perballimit te rrezikut ne kuadrin logjik. Produktet dhe Perfundimet e synuara janë pershtatur me ndryshimin e mjedisit nepermjet rishikimeve ne nje menyre te pershtatshme dhe realiste.

Nga keto qe u thane me lart, programi ka patur nje ndikim te mire ne maksimumin e indikatorëve te perdorur gjate vlerësimit. Ka nje progres ne indikatorët e shoqeruar me buxhetimin sipas politikave dhe ne parashikueshmerine e buxheteve. Për momentin është e veshtire qe te vlerësohet ne terma sasiorë ndikimi ekzakt i programit për shkak se vlera e baze krahasuese nuk ka qene e ndertuar me pare. Gjithsesi, është e dukshme qe ka progres ne anen e planifikimit te shpenzimeve vjetore dhe te ardhurave krahasuar me vlerat e PBA. Nepermjet perdorimit te IPF si nje metode sistematike me hapa te perseritshme, komunat e mbeshtetura ne kuadrin e programit kanë arritur te krijojne PBA te rishikuara dhe me afer realitetit; pritet qe hendeku me plan buxhetet vjetore te te ardhurave/shpenzimeve do te ngushtohet dhe me teper.

Puna e bere ka patur nje ndikim te mire ne procesin e transparences se pergatitjes se buxhetit, perderisa ne sasi informacioni është i disponueshem për publikun, gje qe ne vetvete pritet te rrite pergjegjshmerine e zyrtareve publike dhe te permirësoje cilesine e sistemit lokal te PFM si nje te tere ne te ardhmen.

Ka po ashtu nje ndikim te gjere te programit sidomos ne sasine dhe cilesine e PSZH te prodhuara dhe pershtatjen e tyre me PBA sidomos ne NJQV-te e instruktura ne fazen e dyte te dldp-se. Ne nje rast PSZH është e cilesise shume te mire dhe ka nevojë qe te promovohet si shembull i praktikës se mire ne nivel rajonal dhe kombetar për te rritur me tej mbeshtetjen për programin. Te punuarit nepermjet strategjise se instruktimit ne kohet e ngadalesimit ekonomik ka qene nje menyre teper efçente për te ruajtur ndikimin e programit ne nje menyre te qendrueshme për te ardhmen.

Dimensioni i ngritjes së kapaciteteve është gjithashtu fusha tjetër ku programi duket se ka arritur të ketë një ndikim të mirë në indikatorët dhe në linjë me vlerat e tyre në kuadrin logjik. Kriteri dhe objektivi për gjininë është arritur gjithë kohës, gjë që tregon vetedijen e programit për rëndësinë e këtij kriteri dhe domethënien e tij në kontekstin shqiptar.

### **3.3 Shqyrtimi në tërësi i indikatorëve – Përmbledhje e Gjetjeve**

**Gjetje 1-** Aktualisht, në kontekstin e uljes së ritmeve të rritjes ekonomike, mjedisi i përgjithshëm në Shqipëri për zhvillimin e trajtimeve strategjike në fushën e menaxhimit të financave publike në nivel lokal është sfidues. Si i tillë ai ka të bëjë me burime financiare në ulje për pushtetin lokal si pasojë e transfertave në ulje nga pushteti qendror, dmth shtrengesa buxhetore që detyrojnë pushtetin lokal të përqendrohet në perballimin e realitetit të zgjidhjeve të përditshme me tëper se në aspektet e vendimeve të lidhura me proceset strategjike dhe ato të menaxhimit të financave publike në nivel lokal. IPF është një mjet i dobishëm, i cili nëpërmjet hapave tëper analitike në procesin e përgatitjes së buxhetit afatmesëm, ka mundësinë të shtojë qartësinë dhe realizem procesit të përgatitjes së PSZH.

**Gjetje 2-** Pavarësisht koheve të vështira, njesitë e qeverisjes vendore, dldp-ja, janë duke levizur drejt proceseve standarde të planifikimit strategjik në fushën e menaxhimit të financave publike, rezultatet e të cilave duket të çojnë në vendime me cilësore nga pikepamja e arritshmërisë së programeve dhe aktiviteteve.

**Gjetje 3-** Ndryshimet midis PBA dhe buxheteve vjetore vazhdojnë ende të mbeten të mëdha dhe pavarësisht përmirësimeve rrezikohen nga burime të pasigurta si pasojë e parashikueshmërisë së ulët të transfertave nga qeveria qendrore.

**Gjetje 4-** Përdorimi i mjeteve standarde të planifikimit buxhetor afatmesëm ka rritur cilësinë e përpilimit të PBA, për rrjedhojë produkti IPF ka sjellë përfitime të mëdha për përfundimet e synuara të programit. Gjithsesi, ka nevojë që mjete të tilla të përmirësohen akoma më tej nëpërmjet futjes së standardeve kombëtare sidomos në kodifikimin dhe klasifikimin programatik të shpenzimeve në mënyrë që të përmirësohen akoma më tej mundësitë e shtrirjes në zona të tjera dhe të gjenerohet mbështetje për produktet e dldp-se.

**Gjetje 5-** Pavarësisht progresit modest në parashikueshmërinë e buxheteve, mbetet ende për të bërë në mënyrë që të rritet thellesia dhe qëndrueshmëria e PBA si mjete monitorimi për planifikimin buxhetor. Përdorimi ka zhvillime të reja në lidhje me borxhin publik, është e nevojshme që programi të marrë në konsideratë mundësinë e integritit të vlerësimit të borxhit në IPF dhe në PBA që shkojnë përtej shpalljes së thjeshtë të shumës së huave apo kredive.

**Gjetje 6-** Pavarësisht informacionit pak a shumë të disponueshëm për publikun në procesin e përgatitjes së buxhetit, cilësia e tij ka nevojë të përmirësohet. Ritmet e rritjes ekonomike janë ende shumë të thjeshta dhe të paargumentuara në PBA dhe në PSZH.

**Gjetje 7-** Përfshirja e autoriteteve rajonale si grupe të interesit dhe pale në procesin e përgatitjes së PBA dhe PSZH duket problematike. Po ashtu, prioritetet/mundësitë rajonale dhe kombëtare janë ende larg integritit në PSZH nëpërmjet një kuadri sistematik të vlerësimit të këtyre mundësive.

**Gjetje 8-** Cilësia dhe sasia e PSZH janë përmirësuar me kalimin e kohës. Programi dldp duket se ka luajtur një rol të rëndësishëm këtu nëpërmjet komponentit të tij të aktiviteteve të përqendruara në ndërtimin e kapaciteteve dhe procesit të konsultimit ndërmjet eksperteve të NJQV-ve. Megjithatë PSZH-të në mënyrë të përgjithshme kanë mungesë të shprehjes së aktiviteteve në kosto sipas një standardi të përbashkët në harmoni me PBA, mekanizmat monitorues, entitetet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve, shprehjen në terma sasiore të rreziqeve dhe veprimet që duhen të ndiqen në rast se këto rreziqe materializohen. Metodologjite e shqyrtimit dhe të vlerësimit të mjedisit (SWOT ose të ngjashme me të) janë prezente vetëm në disa nga PSZH e zhvilluara.

**Gjetje 9-** Aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve janë zbatuar sipas programit dhe në përgjithësi kanë rezultuar mirë sipas kuadrit logjik të monitorimit. Kriteri i gjinisë është respektuar, gjë që tregon vetedijen e programit për domethënien e këtij kriteri në mjedisin shqiptar.

**Gjetje 10-** Pavarësisht përmirësimeve në formë dhe në cilësinë e PSZH, ende nuk ka një reflektim ose vendimarrje në lidhje me integritimin e kohezgjatjes së këtyre strategjive dhe procesit të rishikimit.



**Gjetje 11-** Zgjedhja e strategjise se instruktimit ka qene shume efektive ne permirësimin e cilesise se PBA dhe PSZH te zhvilluara.

**Gjetje 12-** IPF eshte nje mjet i dobishem, i cili nepermjet hapave teper analitike ne procesin e pergatitjes se buxhetit afatmesem, ka mundesine te shtojte qartesi dhe realizem procesit te pergatitjes se PSZH.

### 3.4 Mësimet e Nxjerra ne Tërësi

**Mesim 1-** Eshte shume e lehte te fillosh procese strategjike ne fushen e manaxhimit te financave publike ne ekspansion ekonomik dhe eshte shume e veshtire qe te ruash qendrueshmerine e perpjekjes ne periudhat e ngadalësimit te ekonomise. Ekspansioni ekonomik duhet te ndiqet nga fokusi dhe përshtatja me qellim qe te rritet efijensa, te mbahet angazhimi dhe rritet masa e ndikimit ne nivel qendror dhe lokal.

**Mesim 2-** Procesi i planifikimit strategjik dhe PBA jane procese teper komplekse dhe te gjera per tu marre ne te njejten kohe me to. Megjithate perderisa ato jane teper te lidhura me njeri tjetrin, kostoja e perpjekjes shperblehet mjaft mire ne terma te efijenses se rezultateve.

**Mesim 3-** Realizimi i efekteve te proceseve strategjike kerkon kohe sepse ato duhet te misherohen dhe te integrohen si pjese e kultures dhe struktures se zyrave publike. Megjithate, perfitimet nga keto procese jane te gjata ne kohe dhe mund te sigurojne nje mbrojtje te mire ndaj te papriturave ne te ardhmen.

**Mesim 4-** Standartizimi i mjeteve, proceseve dhe klasifikimit rrit efijensen, saktesine dhe mundesine e perhapjes se rezultateve ne nivel rajonal dhe kombetar.

**Mesim 6-** Shtrirja e rezultateve dhe pershtatja me mundesite, prioritetet rajonale dhe kombetare kane potencialin qe te promovojne dhe sigurojne qendrueshmerine e rezultateve ne te ardhmen.

**Mesim 7-** Eshte shume e rendesishme qe para vendimit per te kaluar ne nje faze totale dhe me te avancuar te procedohet nepermjet strategjive pilot, instruktimit dhe te behen ndryshimet e nevojshme ne menyre qe te realizohet ndikimi i plote i shpresuar nga aktivitetet tashme te vena ne jete.

**Mesim 8-** Nje proces i projektimit te kujdesshem te programit me supozime te sakta/qarta dhe me masa per te perballuar rreziqet ka mundesine qe te siguroje nje mjedis relativisht te sigurve per realizimin e produkteve dhe perfundimeve te synuara te programit.

## 4 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### 4.1 Konkluzione

Ne saje te analizes se parashtruar, ky raport arrin ne konkluzionin qe dldp-ja ka qene nje program efektiv dhe pergjithesisht i suksesshem se paku ne fushat e lidhura me perfundimin e synuar 1. Projekt ideja, kalendari dhe aktivitetet duket qe i kane sherbyer mire nevojave te perfituesve dhe siç shihet nga vleresimi i pergjithshem kane patur nje ndikim te mire ne indikatorët per NJQV, objekt i ketij vleresimi.

Perderisa ky program perfundon dhe eshte e nevojshme te merret nje vendim per fazen e ardhshme, ky raport sugjeron si drejtime te aktivitetit ne te ardhmen:

- Thellimin e proceseve cilesore te sistemit te manaxhimit te financave publike ne fusha te tjera te tij p.sh: prokurimet publike, auditimi i brendshem dhe i jashtem etj. siç percaktohen nga ushtrimet standarde ne kete disipline (PEFA)
- Shtrirjen dhe shumefishimin e aktiviteve te programit ne NJQV-te e mbetura ne Shkoder apo Lezhe apo dhe diku tjeter ne Shqiperi.

### 4.2 Rekomandime

Ne lidhje me metodologjine e kombinimit te PSZH dhe PBA ne nje te vetme ne procesin e zbatimit te ketij programi, rekomandohet qe programi te vazhdoje ne te njejten rruge. Proceset, mjetet dhe standardet tashme te zhvilluara do ta bejne koston e aktiviteve te ardhshme me te ulet dhe perfitimi do te jete me i madh. Megjithate, çdo program i ri duhet t'i kushtojte vemendje pershtatjes me standardet

kombetare ne menyre qe te promovohet dhe sigurohet qendrueshmeria e rezultateve te arritura ne te ardhmen.

Programi ka nevoje qe te kapitalizojë ne iniciativat, standardet, udhezimet rajonale dhe kombetare ne menyre qe te rrise ndikimin e tij veçanerisht ne fushat qe kane nje lidhje direkte me manaxhimin e financave publike (disponueshmeria e informacionit te buxhetit, kanalet e komunikimit, kalendari i aprovimit te buxhetit, struktura e raporteve dhe formateve te buxhetit etc.)

Ka nevoje per me teper pune ne menyre qe PBA-te te jene mekanizma qe jo vetem t'i sherbejne procesit te hartimit te PSZH por edhe te monitorimit te tij. PBA ka nevoje qe te behen programe me indikatorë, rreziqet perkatese, pergjegjesi dhe veprime qe duhet te kryhen nese objektivi i synuar nuk arrihet.

Eshte e nevojshme pershtatja me iniciativat ne nivel kombetar per te rritur menyre dhe shtrirjen e te ardhurave lokale me te tjera taksa ose per te krijuar "zona relativisht te sigurta" per te ardhurat lokale ne menyre qe te garantohet siguria e parashikimeve fiskale te te ardhurave/shpenzimeve lokale dhe rrjedhimisht sherbimet publike.

PSZH te integrojne nje shqyrtim te detajuar te mundesive rajonale dhe kombetare dhe te permbajne plane veprimesh sa me afer realitetit nepermjet PBA.

Mjeti i Planifikimit Financiar (IPF) te shtrihet ne pjesen e mbetur te komunave me permirësime shtese te pershtatura me zhvillimet kombetare; si nje shembull ilustrimi, programi mund te mendoje per mundesine e zgjerimit ose te shtimit te nje moduli te dedikuar borxhit.

Eshte e nevojshme qe dldp-ja te kapitalizojë dhe promovojë disa nga materialet e zhvilluara ne programe si shembuj te praktikave te mira dhe te mbeshtese çdo inicitative kombetare per ushtrime standarde ne fushen e manaxhimit te financave publike (si p.sh. PEFA lokale- shkurt Shqyrtimi i Kuadrit te Shpenzimeve Publike ne nivel lokal), te cilat mund te rrisin vetedijen rajonale dhe kombetare per programin dhe suportin per perfundimet e synuara te tij.

Praktika e konsultimeve ndermjet eksperteve te NJQV duhet te jete pjese e procesit dhe kurdohere qe te jete e mundur duhet te perfshije perfaqesues nga niveli rajonal dhe kombetar i qeverise ne menyre qe te lehtesojë perfshirjen e tyre ne procesin e PBA dhe PSZH dhe te rrise ndikimin pertej zones se programit.

## **5 ANEKSE**

**ANEKSI 1: INDIKATORET DHE METODOLOGJIA E MATJES**

**ANEKSI 2: PYETESORI**

**ANEKSI 3: SITUATA EKONOMIKE**

### ANEKSI 1: INDIKATORET DHE METODOLOGJIA E MATJES

Përfundimet	Domethenia	Indikatorët	Metodologjia e Matjes	Baza e Krahasimit	Burimi i Verifikimit
<p><b>Përfundimi i Synuar 1:</b></p> <p>Praktika të mira janë bërë të ditura në nivel kombëtar në bashkepunim me shoqatat duke ndikuar kështu në ligj, vendimmarrje dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar</p>	Buxhetet e mbeshetura ne Politika	IP-1: Numri i projekteve strategjike ne plan buxhetet vjetore dhe planet strategjike	Llogaritja e projekteve strategjike	2010 si bazë krahasuese	Plan-buxhete vjetore dhe PSZH
		IP-2: Pjesa relative e projekteve strategjike ne plan buxhetet vjetore	Vlerësimi i pjesës se shpenzimeve të planifikuara për projekte strategjike ne plan buxhete vjetore	2010 si bazë krahasuese	Plan-buxhete vjetore dhe PSZH
	Parashikueshmëria e buxheteve	IP-3 : Devijimi i pergjithshem i shifrave ne plan buxhetet vjetore nga ato ne PBA ne lidhje me shpenzimet	Diferenca midis nivelit të planifikuara të shpenzimeve në plan buxhetin vjetor dhe nivelit përkatës në PBA e vitit parardhës	- Devijim < 5%: A - Devijim < 10%: B - Devijim < 15%: C - Devijim > 15% : D	Plan-buxhete vjetore dhe PBA
		IP-4: Devijimi i pergjithshem i shifrave ne plan buxhetet vjetore nga ato ne PBA ne lidhje me të ardhurat	Diferenca midis nivelit të planifikuara të të ardhurave në plan buxhetin vjetor dhe nivelit përkatës në PBA e vitit parardhës	- Devijim < 5%: A - Devijim < 10%: B - Devijim < 15%: C - Devijim > 15% : D	Plan-buxhete vjetore dhe PBA
		IP-5 : Devijimi i programeve te shpenzimeve siç planifikohet ne plan buxhetet vjetore ne raport me PBA.	Kovarianca në përbërjen e shpenzimeve	Kovarianca e shpenzimeve në tri vitet e fundit (2010 si bazë krahasuese)	Plan-buxhete vjetore dhe PBA
	Planifikimi dhe buxhetimi transparent dhe me pjesëmarrje	IP-6: Disponueshmëria e informacionit per buxhetin	Numërimi i elementëve të rëndësishëm ne dokumentin e buxhetit	Dokumenti i buxhetit duket të japë informacion për të gjithë elementet e parashikimeve dhe propozimeve buxhetore si dhe për ato të vitit të kaluar: Asnjë informacion nuk mungon A 1 Informacion mungon B 2 Informacione mungojnë C > Informacione mungojnë D (2010 si bazë krahasuese)	Dokumentet e buxhetit që janë të disponueshme në NJQV
		IP -7: Pjesëmarrja ne planifikimin strategjik	Përfshirja aktive e grupeve të interesit në planifikimin strategjik	> 70% e grup të interesit: A > 50% e grup të interesit: B > 30% e grup të interesit: C < 30% e grup të interesit: D (2010 si bazë krahasuese)	Dokumentet e PSZH te NJQV
		IP -8: Pjesëmarrja ne krijimin e PBA	Përfshirja aktive e departamenteve të linjës në krijimin e PBA në njësitë vendore të instruktuar	100%: A > 60%: B > 35%: C < 35%: D (2010 si bazë krahasues)	Dokumente të procesit në NJQV e instruktuar
		IP -9: Komunikimi ne informacionin mbi buxhetin	Kanalet e komunikimit	> 5 elementë: A > 4 elementë: B > 2 elementë: C	Evidencë nga NJQV

<p><b>Përfundimi i Synuar 1:</b></p> <p>Praktika të mira janë bërë të ditura në nivel kombëtar në koperim me shoqatat duke ndikuar keshtu ligjin, vendimarrje dhe zbatimin e tyre në nivel kombëta</p>				< 2 elementë: D (2010 si bazë krahasues)	
	PSZH te integruara vertikalisht	IP-10: Sa shume PSZH reflektojne mundesite dhe kufizimet e planeve rajonale dhe kombetare per NJQV?	Kontrolli i PSZH të NJQV	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Procese sistematike të planifikuara: A</li> <li>- Procese Ad hoc të planifikuara: B</li> <li>- Refleksione Ad hoc pa masa të planifikuara: C</li> <li>- Jo reflektrim: D</li> </ul>	PSZH e NJQV
	Kapacitete të rritura në NJQV për PSZH/PBA	IP-1: Numri i zyrtarëve të NJQV dhe i anëtarëve të Këshillit te trainuar në PSZH/PBA	Numërimi i pjesëmarrësve në sesione dhe klasifikimi i gjinisë	Kuadri Logjik Pyetesor Numri i të punësuarve në departamente Gjinia	Statistikat e Sesioneve
		IP-12: Numri i NJQV-ve të trainuara në PSZH/PBA	Numërimi i NJQV-ve të përfshira	Kuadri Logjik Pyetesor Numri i të punësuarve në departamente Gjinia	Statistikat e Sesioneve
		IP-13: Numri i NJQV-ve te instruktuar në PSZH dhe përqindja e zyrtareve të NJQV të përfshirë	Numërimi i NJQV-ve të përfshira dhe i zyrtarëve të përfshirë	Kuadri Logjik Pyetesor Numri i të punësuarve në departamente Gjinia	Statistikat e Sesioneve
		IP -14: Numri i NJQV Numërimi i NJQV-ve të përfshira dhe i zyrtarëve të përfshirë të instruktuar në PBA dhe përqindja e zyrtareve të NJQV Numërimi i NJQV-ve të përfshira dhe i zyrtarëve të përfshirë të përfshirë	Numërimi i NJQV-ve të përfshira dhe i zyrtarëve të përfshirë	Objektiv sipas Metodës pilot Objektiv sipas Metodës e përhapjes	Statistikat e Sesioneve
		IP-15: Numri i NJQV Numërimi i NJQV-ve të përfshira dhe i zyrtarëve të përfshirë të instruktuar në aplikimin e IPF dhe përqindja e zyrtarëve të përfshirë	Numërimi i NJQV-ve të përfshira dhe i zyrtarëve të përfshirë	Objektiv sipas Metodës pilot Objektiv sipas Metodës e përhapjes	Statistikat e Sesioneve
	Prani e rritur e PSZH/ PBA në NJQV	IP-16: PSZH të reja te krijuara	Numërimi	Po apo jo dhe sa	Dokumentat e reja të PSZH
		IP-17: PSZH të përditësuara	Numërimi	Po apo jo dhe sa	Dokumenta e përditësuar të PSZH
		IP-18: A i respektojnë PBA e prodhuara ne NJQV e qarkut Shkoder dhe Lezhe rekomandimet e dldp-se?	Kontrolli i PBA pasi të jenë specifikuar standardet minimale	> 80% plotësohen: A > 60% plotësohen: B > 35% plotësohen: C < 35% plotësohen: D	Dokumentet e PBA

<p><b>Përfundimi i synuar 2:</b> Praktika të mira janë bërë të ditura në nivel kombëtar në bashkepunim me shoqatat duke ndikuar keshtu ne ligj, vendimmarrj e dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar</p>		IP-19: IPF versioni final	Versioni final i IPF	-Po/Jo Kuadri Logjik (Fundi i Janarit)	Funksionaliteti i IPF i konfirmuar nga kompanitë që ofrojnë shërbimin
		IP-20: PBA të krijuar duke përdorur IPF	Kontrolli i PBA të krijuara	-Po Jo dhe Numri	Kopjet në letër apo elektronike të planeve financiare
	<p>Influenca rajonale dhe kombëtare dhe transferimi i njohurive</p>	IP -21 Rekomandimet e dldp-se/grupit të ekspertëve ndërNJQV a që janë adoptuar në nivel kombëtar në rregullore, udhëzime, ligje apo praktika kombëtare	Numërimi i elementëve në rregullore, udhëzime, ligje apo praktika kombëtare	> 5 elementë: A > 3 elementë: B > 1 elementë: C < 2 elementë: D	Draftet e rregulloreve, udhëzimeve, ligjeve apo praktikve kombëtare
		IP -22 Praktika të promovuara nga dldp-ja dhe të adoptuara në NJQV partnere në bashkitë e Qarkut Shkodër, Lezhë .	Identifikimi i praktikave relevante në NJQV partnere	> 20 raste: A > 10 raste: B > 3 raste: C < 4 raste: D	Intervista në prefektura apo dokumentime të rasteve

## ANEKSI 2: PYETESORI

### Buxhete të bazuara në politika

1. Cili është numri i projekteve të parashikuara në planin strategjik?
2. Sa nga këto projekte strategjike janë përfshirë në buxhetin vjetor gjatë viteve?  
2010 2011 2012 2013
3. Cili është numri i projekteve në planin e investimeve kapitale?
4. Sa nga këto projekte strategjike janë planifikuar në planin e investimeve kapitale gjatë viteve?  
2010 2011 2012 2013

Sa është % qe zënë në buxhetin vjetor projektet strategjike/investimet kapitale %?  
2010 2011 2012 2013

### Parashikueshmëria e buxheteve

1. Sa ka qenë buxheti i NJQV-ve për vitet e mëposhtme? (specifiko nga 2010-2013)
2. Sa kanë qenë shpenzimet e parashikuara ne buxhet në PBA qe nga 2010. Specifiko për çdo vit që nga viti 2010.

### Planifikimi i politikave dhe buxhetimi transparent dhe pjesëmarrja

A përfshijnë dokumentet tuaja të buxhetit informacione të aksesueshme për publikun në lidhje me:

1. Supozimet makro-ekonomike, duke përfshirë vlerësime të rritjes, inflacionin dhe kursin e këmbimit.  
Po  Jo
2. Asete financiare duke përfshirë detaje të paktën për fillimin e vitit aktual.  
Po  Jo
3. Buxheti i vitit të kaluar i prezantuar në të njëjtin format me propozimin e buxhetit  
Po  Jo
4. Buxheti vitit aktual (ose buxheti i rishikuar apo vlerësimi), i prezantuar në të njëjtën format me propozimin e buxheti.  
Po  Jo
5. Të dhëna të përmbledhura të buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet sipas klasifikimeve kryesore të përdorura (ref. PI-5), përfshi edhe të dhëna për vitin korrent dhe vitin e mëparshëm.  
Po  Jo

6. Përshkrim i iniciativave te reja në buxhet, me vlerësime të impaktit të tyre në buxhet në politikat e të ardhurave apo shpenzimet e programeve.

Po  Jo

Cili nga këto institucione, grupe apo individë janë përfshirë në procesin e hartimit dhe rishikimit të planit strategjik?

- Qytetarët
- Komunitete fqinje (në rastet kur PSZH 2 a më shumë njësi vendore duan të zhvillojnë një plan të përbashkët)
- Këshillat lokale (bashkiake/komunale)
- Kryetarët e komisioneve bashkiake apo komunale
- Ofrues shërbimi private apo publikë apo agjenci
- Konsulentë apo agjenci konsulence
- Operatorë Ekonomikë
- OJF
- Shoqata biznesi/grupe apo përfaqësues
- Institucione Publike (përfshi sporte, shëndetsi dhe kulturë)
- Media lokale dhe kombetare
- Te moshuarit (Përfaqësuesit e fshatrave në komuna)
- Përfaqësues të besimeve fetare në zonë
- Universitete (nqs ka)
- Përfaqësues politikë të zonës
- Agjenci rajonale të Arsimit
  - Agjenci rajonale të shëndetit
  - Agjenci rajonale të bujqësisë
  - Agjenci rajonale të punës
  - Agjenci rajonale të tatim taksave
- Përfaqësues të këshillit Qarkut
- Përfaqësues të shoqatave të grave
- (Përfaqësues të minoriteteve (nqs ka)
- Përfaqësues të OJF rinore
- Të tjerë (psh. Shoqata emigrantesh, fermeresh, etj.), nqs i sherbejne planikimit dhe zbatimit

Shëno kutinë

Cili nga departamentet e linjës është përfshirë në hartimin e PBA?

- Financat
- Taksat



- Shërbimet Publike
- Zhvillimi ekonomik
- Shërbimet sociale
- Kultura, sportet, shëndetsia
- Bujqësia
- Pyjet
- Policia bashkiake(komunare)
- Seksioni Juridik
- Inspektoriati Ndertimor

Shëno kutinë

PSZH e integruar vertikalisht

Cilin dokument strategjik keni konsultuar gjatë hartimit të planit strategjik?

- NSDI
- Strategji sektoriale (specifiko cilën)
- Strategji ndërsektoriale
- Strategji Rajonale, plane dhe dokumente (specifiko cilën)

A është strategjia juaj e harmonizuar në nivel të:

- Objektivave
- Projekteve
- Indikatorëve
- Tjetër (të lutem specifiko)

Influencë në nivel kombëtar dhe transferim njohurish

A e keni përdorur eksperiencën e fituar nga dldp-ja për të bashkëpunuar me aktorë të tjerë? (nqs po, cilët?)

A e keni përdorur eksperiencën e fituar nga dldp-ja për të bashkëpunuar me NJQV të tjera? (nqs po, cilët?)

### ANEKSI 3: SITUATA EKONOMIKE

Shqipëria: Indikatorët Bazë dhe Kuadri Makroekonomike, 2009-17

	2009	2010	2011Est.	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>GDP</b> (Growth rate in percent)									
Real GDP 1/	3.3	3.5	3.0	0.5	1.3	2.5	2.5	2.5	2.5
Consumer Price Index (avg.)	2.2	3.6	3.4	2.2	3.2	3.0	3.0	3.0	3.0
Consumer Price Index (eop)	3.7	3.4	1.7	3.4	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0
GDP deflator	2.3	3.8	3.5	2.4	3.1	2.8	2.8	2.8	2.9
<b>Saving-investment balance</b> (Percent of GDP)									
Foreign savings	14.0	11.4	11.9	10.1	9.4	8.8	8.3	7.1	5.8
National savings	16.2	15.4	13.7	13.9	13.0	12.7	12.4	12.9	13.4
Public	1.0	1.2	1.6	1.1	0.9	0.7	0.4	0.2	0.1
Private	15.2	14.2	12.1	12.8	12.1	12.1	12.0	12.7	13.3
Investment	30.3	26.8	25.6	24.0	22.3	21.5	20.7	19.9	19.1
Public	10.1	6.7	6.0	4.9	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0
Private	20.2	20.1	19.6	19.1	18.3	17.5	16.7	15.9	15.1
<b>Fiscal sector</b>									
Revenues and grants	26.0	25.8	25.1	24.8	24.9	24.8	24.8	24.7	24.6
Tax revenue	23.5	23.3	23.0	22.7	22.7	22.7	22.6	22.5	22.4
Expenditures	33.4	29.6	28.5	27.9	27.1	27.3	27.5	27.6	27.6
Primary	30.2	26.2	25.4	24.7	23.7	23.7	23.7	23.7	23.7
Interest	3.2	3.4	3.1	3.2	3.4	3.5	3.8	3.8	3.9
Overall balance (including grants)	-7.4	-3.7	-3.5	-3.1	-2.2	-2.4	-2.7	-2.9	-3.0
Primary balance (including grants)	-4.3	-0.4	-0.3	0.2	1.1	1.1	1.0	0.9	0.8
Net domestic borrowing	0.9	0.9	2.0	1.8	0.7	1.9	2.5	3.0	3.9
Privatization receipts	2.4	0.4	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Foreign financing	3.7	2.1	1.6	1.4	1.5	0.6	0.3	-0.1	-0.9
Public Debt	59.3	57.8	58.6	60.9	60.8	60.5	60.4	60.4	60.5
Domestic	36.1	32.9	33.3	34.1	33.4	33.5	34.3	35.5	37.6
External (including publicly guaranteed)	23.2	24.9	25.3	26.8	27.4	27.0	26.1	24.9	22.8
<b>Monetary indicators</b>									
Broad money growth	6.8	12.5	9.1	6.1	4.4	5.3	5.4	5.4	5.4
Private credit growth	10.3	10.1	10.4	2.1	4.5	5.8	4.7	3.8	0.4
Velocity	1.3	1.3	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2
Interest rate (3-mth T-bills, end-period)	6.3	5.3	5.3	...	...	...	...	...	...
<b>External sector</b> (Percent of GDP unless otherwise indicated)									
Trade balance (goods and services)	-24.6	-20.7	-22.4	-18.8	-17.6	-17.3	-16.9	-16.2	-15.2
Current account balance (including official transfers)	-14.0	-11.4	-11.9	-10.1	-9.4	-8.8	-8.3	-7.1	-5.8
Current account balance (excluding official transfers)	-14.7	-11.9	-12.2	-10.8	-10.1	-9.5	-9.0	-7.8	-6.5
Official transfers	0.7	0.5	0.2	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
Gross international reserves (in millions of Euros)	1,621	1,926	1,879	1,976	2,065	2,101	2,160	2,296	2,495
(In months of imports of goods and services)	4.1	4.4	4.4	4.5	4.5	4.4	4.4	4.5	4.5
(Relative to external debt service)	10.9	5.0	8.8	8.2	6.5	5.3	2.8	5.0	5.5
(In percent of broad money)	26.0	27.0	24.9	24.4	24.6	24.0	23.6	24.0	24.8
Change in real exchange rate (eop, in percent)	-7.8	-2.6	0.7	...	...	...	...	...	...
<b>Memorandum items</b>									
Nominal GDP (in billions of lek)	1,151	1,237	1,319	1,357	1,417	1,493	1,574	1,659	1,749

Burimi: FMN, "Albania, Country Report No: 13/7" January 2013. Burimet e te dhenave janë nga autoritetet shqiptare, vlerësimet e stafit të FMN. 1/ të dhënat për PPBr 2008-09 janë marrë nga llogaritë kombëtare zyrtare.